



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**ANALIZE**  
**E**  
**TREGUT**  
**TE SHUMICES TE AKSESIT NE BROADBAND DHE AKSESIT**  
**NE INFRASTRUKTUREN FIZIKE (LLU)**

- 1) Tregu me shumice te aksesit broadband
- 2) Tregu me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.

**Draft per Konsultim**

**13 Prill 2010**

## INDEKSI I PERMBAJTJES

<b>I. PERMBLEDHJE .....</b>	<b>4</b>
<b>II. HYRJE .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>II.1. PANORAME E BROADBAND NE SHQIPERI .....</b>	<b>14</b>
<b>II.2 PERCAKTIMI I SIPERMARRESVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG .....</b>	<b>16</b>
<i>I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator.....</i>	<i>16</i>
<i>II. Procesi i Konsultimit .....</i>	<i>17</i>
<i>III. Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës.....</i>	<i>18</i>
<i>IV. Struktura e Dokumentit .....</i>	<i>18</i>
<i>V. Perkufizimi i tregut perkates.....</i>	<i>18</i>
<i>VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese .....</i>	<i>21</i>
<b>III. AKSESI NE TREGUN E BROADBAND DHE PERSHKRIMI TIJ .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>III. 1 PERSHKRIMI I TREGUT TE PAKICES TE AKSESIT NE BROADBAND. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>	
<b>III. 2 PERSHKRIMI I AKSESIT SIPAS TEKNOLOGJIVE QE MUNDESOHET. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>	
<b>IV. ANALIZE E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND .....</b>	<b>38</b>
<b>IV.1. PERKUFIZIMI I TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND .....</b>	<b>38</b>
<i>I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut me shumice te aksesit ne broadband .....</i>	<i>38</i>
<i>II. Dimensioni gjeografik i tregut.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<b>IV.2 ANALIZA PER FUQI TE NDJESHME NE TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND.....</b>	<b>47</b>
<i>I. Pjeset e tregut .....</i>	<i>47</i>
<i>II. Pengesat per hyrje dhe Konkurrenca e mundshme ne tregun e aksesit ne broadband.....</i>	<i>512</i>
<i>III. Fuqia kundervepruese e bleresve te aksesit ne nivel shumice.....</i>	<i>54</i>
<i>IV. Krahasime te Broadband ne Shqiperi me vendet e BE-se dhe te rajonit...Error! Bookmark not defined.</i>	
<i>V. Perfundime mbi FNT.....</i>	<i>64</i>
<b>V. MASAT RREGULLUESE NE TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND .....</b>	<b>88</b>
<b>V.1 PROBLEMET NE KONKURRENCE DHE PERVOJAT RREGULLATORE .. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>	
<b>V.2 MASAT RREGULLUESE PER ALBTELECOM: AKSESI NE TREGUN E SHUMICES NE BROADBAND .... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>	
<b>ANEKS 1. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIM PUBLIK PER BROADBAND .....</b>	<b>69</b>
<b>VI. ANALIZE E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT FIZIK NE LLU .....</b>	<b>70</b>
<b>VI.1. PERKUFIZIMI I TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE INFRASTRUKTUREN FIZIKE (LLU).....</b>	<b>70</b>
<i>I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut me shumice te aksesit fizik(full dhe shared LLU).....</i>	<i>71</i>
<i>II. Dimensioni gjeografik i tregut.....</i>	<i>76</i>
<b>VI.2 ANALIZA PER FNT: TREGU ME SHUMICE AKSESIT NE LLU .....</b>	<b>78</b>
<i>I. Pjeset e tregut .....</i>	<i>78</i>
<i>II. Pengesat per hyrje dhe Konkurrenca e mundshme ne tregun e linjave me qera.....</i>	<i>79</i>
<i>III. Fuqia kundervepruese e bleresve te linjave me qera .....</i>	<i>81</i>
<i>IV. Pervoja rregullatore ne vendet BE-se.....</i>	<i>82</i>
<i>V. Perfundim per FNT.....</i>	<i>86</i>
<b>VII. MASAT RREGULLUESE PER FNT NE TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT NE LLU .....</b>	<b>88</b>
<b>VII.1 PROBLEMET NE KONKURRENCE DHE PERVOJA RREGULLATORE.....</b>	<b>88</b>

VII.2 MASAT RREGULLUESE PER ALBTELECOM: AKSESI FIZIK NE TREGUN E SHUMICES NE LLU .....	89
ANEKS 2. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIM PUBLIK PER LLU .....	92

## INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

### Figura nga evidentimi i te dhenave te tregut

Fig1. Pesha ne treg sipas teknologjive qe mundesojne akses ne broadband.....	
Fig 2. Pesha ne treg e operatoreve kryesore per teknologjine x DSL.....	
Fig 3. Numri linjave ADSL per Albtelekom dhe te tjeret ne tregun e broadband.....	
Fig.4 Perdorues interneti bazuar ne rrjetin GSM (klasifikuar ne familjare dhe biznes).....	
Fig.5 Totali i linjave broadband (Albtelecom dhe te tjeret).....	
Fig.6 % e aksesit ne broadband sipas teknologjive.....	
Fig.7 Aksesit ne narrowband dhe broadband (sipas nr te lidhjeve).....	
Fig.8 Pesha e operatoreve ne % sipas nr te lidhjeve per sherbimin ADSL.....	

### Krahasimi rajonal dhe BE sipas te dhenave te Cullen International

Figure 1 - Broadband penetration rate, July 2009.....	
Figure 2 - Fixed retail broadband connections by incumbent and alternative operators.....	
Figure 3 - Competition in retail xDSL.....	
Figure 4 - Fixed retail broadband connections by technology.....	
Figure 5 - Broadband 512 kbps monthly subscription charges in euro, including VAT.....	
Figure 6 - Broadband 1 Mbps monthly subscription charges in euro, including VAT.....	
Figure 7 - Broadband 2 Mbps monthly subscription charges in euro, including VAT.....	
Fig.1-Fig.8 (Broadbans access in the EU - July 2008).....	

## I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918) qe hyri ne fuqi me 26.06.2009, ne nenin 1 te tij, percakton se:

Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument permban analizen e tregjeve me shumice te aksesit ne broadband si dhe te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve te hapura, dhe konkretisht tregjet nr. 15 dhe 14 te Rregullores se Analizes se Tregut (ne vijim referuar si Rregullore):

- 1) Tregu me shumice te aksesit broadband
- 2) Tregu me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perفشire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.

Ne renditjen e ketyre tregjeve ne kete material, tregu nr.15 (sipas listes se tregjeve ne rregulloren e analizes) eshte renditur para tregut nr.14. (kjo thjesht per orinetim te lexuesit).

Ne perfundim te procesit te kesaj analize te nisur, AKEP do te marre vendime ne lidhje me FNT si dhe masat rregulluese te nevojshme ne rast te gjetjes se FNT ne tregjet e analizuara

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne RSH", parashikon ne Nenin 35 te tij proceduren e keshillimit me palet e interesit per analize e tregut duke vendosur si afat periudhen kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara. Ne kete menyre, AKEP mirepret komentet e paleve te interesuara deri 60 dite nga data e publikimit ne faqen e Internetit te AKEP, per perfundimet ne lidhje me FNT dhe detyrimet e propozuara nga AKEP per FNT. Komentet e paleve te interesuara do te publikohen nga AKEP, se bashku me dokumentin final te analizes se tregut dhe vendimet per FNT.

Kjo analize e tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin lolal LLU si dhe tregut te shumices te aksesit ne broadband zhvillohen per here te pare ne Shqiperi. Ne fazen e procesit te mbledhjes se te dhenave te hartuara sipas pyetesoreve , si dhe te disa perfundimeve paraprake te arritura ne analizimin e ketyre te dhenave, eshte organizuar edhe nje workshop qe lidhej me kete treg dhe rregulloren e analizes se tregut e cila eshte zhvilluar me lojtaret e tregut dhe me projektin e konsulences se BERZH ne muajin Qershor 2009.

**Nga analiza e tregut me shumice te aksesit ne broadband rezulton:**

Paraprakisht eshte bere nje pershkrim i tregut te pakices te aksesit ne broadband, i teknologjive qe mundesojne kete akses si dhe eshte trajtuar mundesia e zevendesueshmerise ne nivel kerkesa/oferte per produktet dhe sherbimet ne nivelin e pakices.

Sipas ketij pershkrimi, aksesit ne broadband mundesohet ne keto menyra:

- a) akses ne broadband duke u mbeshtetur mbi nje rrjet publik telefonik fiks nga nje vendodhje fikse.
- b) Akses ne broadband duke shfrytezuar linja kabllore (infrastrukture te ngritur nga ana e ISP-ve)
- c) Akses ne broadband duke shfrytezuar teknologji te tjera te cilat bazohen ne perdorimin e frekuencave

Ne pershkrimin e bere ne nivelin e pakices eshte konkluduar se pavaresisht teknologjise qe mundeson aksesin, kerkesat e origjinuara ne nivelin e pakices gjejne zgjidhje ne tregun e shumices dhe rrjedhimisht ne aspektin e zevendesueshmerise se ketyre kerkesave ne nivelin e pakices per llojet e aksesit si:

- a) Aksesit kabllor, ADSL, FWA (ose tjeter teknologji), varet nga numri i kerkesave ne tregun e pakices, kerkesa te cilat mund te plotesojne kriterin e zevendesueshmerise ne "retail", bejne pjese ne te njejtin treg.
- b) Te gjitha vetefurnizimet plotesojne kriterin e zevendesueshmerise ne "retail", per rrjedhoje tregon qe keto vetefurnizime pavaresisht teknologjise mbi te cilen mbeshteten perfshihen ne te njejtin treg.

#### **Ne lidhje me aksesin mund te themi qe korniza e tregut te pakices perfshin:**

- a) Aksesit qe realizohet ne Narrowband apo Broadband per tregun e pakices, duhet konsideruar si pjese e te njejtit treg , edhe pse jo ne perputhje te plote te karakteristikave funksionale, duke perjashtuar "produktet dhe sherbimet qe mundeson" ky akses.
- b) Aksesit i realizuar mbi te gjitha platformat qe shfrytezojne teknologjite XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologjine kabllore, FWA apo teknologji te tjera qe mundesojne aksesin ne broadband ne tregun e pakices, jane pjese te te njejtit treg.
- c) Aksesit i realizuar per te dy kategorite (familjar + biznes), ne tregun e pakices, eshte pjese e te njejtit treg.

#### **Analiza e tregut te shumices te aksesit ne Broadband**

Tregu shumices te aksesit ne broadband, eshte perkufizuar i njejte me perkufizimin e dhene ne rekomandimin e KE te vitit 2003 per tregjet perkates, dhe se ne percaktimin e dimesionit gjeografik te sherbimit te aksesit eshte konkluduar se:

- *Dimensioni gjeografik i shërbimit të aksesit në broadband në tregun e shumicës, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.*

Percaktimi i tregut me shumicë të aksesit në broadband përfshin:

- a) Tregun me shumicë aksesit në broadband;
- b) Dimensionin gjeografik i tregut është kombëtar;

*Per rrjedhojë:*

*Aksesi i realizuar mbi të gjitha platformat që shfrytëzojnë teknologjitë XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologjinë kabllorë, FWA apo teknologji të tjera që mundësojnë aksesin në broadband bëjnë pjesë të të njëjtit treg të shumicës.*

Kërkesat e gjeneruara nga tregu i pakicës sipas përshkrimit të bërë, për secilën teknologji që mundëson këtë akses, gjëja zgjidhje në tregun e shumicës të aksesit në broadband dhe për rrjedhojë në analizën e bërë në këtë treg, AKEP ka konkluduar se:

***Tregu i shumicës të aksesit në broadband nuk është në konkurrencë efektive dhe vlerëson që Albtelecom ka FN në këtë treg, d.m.th që ka një pozicion dominues në zhvillimin e këtij tregu.***

AKEP, ka analizuar faktorët në përputhje me Nenin 33 të Ligjit, duke argumentuar se Albtelecom ka një kontroll mbi infrastrukturën bazë që mundëson zhvillimin e konkurrencës efektive të këtij tregu të bazuar në madhësinë e rrjetit, fuqinë e ulët kundërvepruesë të blerësve, ekonomisë së shkalles dhe të dendësise, integrimin vertikal etj. Bazuar në këta faktorë të rendesishëm si dhe në matjet e tregut në %, të aksesit në broadband sipas teknologjive kryesore rezultoi se: Albtelecom ka pozicionin dominant në këtë treg, d.m.th është me FN në tregun e shumicës të aksesit në broadband.

AKEP, pasi ka përshkruar teknologjitë që mundësojnë aksesin në broadband në tregun e shumicës, numrin e sipërmarësve që ofrojnë këtë akses në këtë nivel, është arritur në konkluzionin që dimensionin gjeografik i këtij tregu është kombëtar.

### **Perfundime mbi FNT për tregun e shumicës të aksesit në broadband**

Sipas analizës së bërë për faktorët e marrë në konsideratë në lidhje me fuqinë e ndjeshme në treg, rezultoi se:

- Albtelecom zoteron pjesë tregu në nivele mbi 50% të aksesit në broadband në nivel shumicë.
- Albtelecom është aktualisht operator me FNT në tregun me pakicë të aksesit në rrjetin telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe është gjetur si OFNT edhe në “Analizën e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse: versioni përfundimtar”, përfunduar në vitin 2009, si dhe në Analizën e Linjave me Qera në tregun e pakicës dhe të shumicës të përfunduar në Janar 2010

- Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rendesishem per te shtrire FNT ne tregun me shumice te aksesit ne broadband dhe potencialisht i mundshem per te transferuar kete FN ne tregun e pakices te aksesit ne broadband.
- Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me hyrjet e reja ne tregun e aksesit ne broadband.
- Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh edhe ne ofrimin e aksesit ne broadband.
- Mbulimi i kufizuar territorial nga operoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem me Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar akses ne broadband bazuar mbi rrjetin fiks te telefonise apo lidhje te dedikuara ne zona te ndryshme gjeografike.
- Aftesia e konkurrences se mundshme ne kete treg, ne formen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurruese te operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me Albtelecom ne ofrimin e aksesit ne broadband.
- Megjithate eliminimin apo reduktimin e ndjeshem te pengesave ligjore, qe erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator te Autorizimeve te Pergjithshme, Albtelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere per shkak te ekonomive te shkalles, ekonomive te densitetit, integritimit vertikal. Keto avantazhe te Albtelecom, ne rrjetin lokal dhe backbone, ndikojne pozitivisht ne aftesine ndikuese te Albtelecom ne tregun me shumice te aksesit ne broadband.

#### **Bazuar ne analizen e bere eshte konkluduar qe:**

**Albtelecom permbush kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregun perkates me shumice te aksesit ne broadband duke e propozuar sipas kesaj analize si OFNT.**

#### **Problemet e identifikuara qe pengojne konkurrencen efektive ne kete treg**

Ne percaktimin e masave rregulluese per Albtelecom jane konsideruar problemet e mundshme qe pengojne konkurrencen dhe jane konsideruar si praktika referuese edhe problemet e identifikuara sipas analizave te mbajtura dhe te zhvilluara nga Rregullatoret Europiane ne lidhje me aksesin ne broadband ne tregun e shumices.

Nder problemet e evidentuara si me te qenesishme dhe si te tilla jane vecuar:

- Integrimi vertikal;
- Integrimi horizontal;
- Dominanca individuale;

Sejcili nga keto probleme ne vetvete permban elemente te tjere konkret te cilet ndikojne ne zhvillimin e konkurrences efektive dhe qe duhen trajtuar si faktore pengues.

Grupi i Rregullatoreve Europiane (ERG) ne dokumentin , ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006, citon se per shkak te mundesive dhe stimujve te krijura nga transmetimi i FNT vertikalisht apo horizontalisht, si dhe nga dominanca individuale e nje operatori ne treg, shpesh egzistojne dhe lindin probleme per konkurrencen, te lidhura me cmimin ose jo, si:

- refuzimi per te dhene akses;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- tarifa jo te arsyeshme;
- diskriminim ne tarifa dhe cilesi;
- subvencionim i terthorte;
- investim i tepert apo i manget;
- dhenia e sherbimeve me shporta (bashkimi i sherbimeve) etj

### **Masat Rregulluese per Albtelekom**

Ne baze te parashikimeve te ligjit, neni 34, *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuara në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe se detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet te jene proporcionale me natyren e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

Bazuar ne pershkrimin e problematikes se cituar me siper, AKEP gjykon se masat e nevojshme qe duhen propozuar ne kete draft analize per t'u vendosur ndaj Albtelecom, me reference ne parashikimet e Ligjit 9918, jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

**Nga analiza e tregut me shumice te aksesit ne infrsaturtoren fizike te rrjetit lokal te hapur (LLU), rezulton:**



Ne tregun e shumices te aksesit fizik ne rrjetin lokal (LLU), ne kete dokument paraprakisht eshte bere nje pershkrim per sejcilin nga produktet e identifikuara ne kete treg, (full dhe shared access) dhe duke e trajtuar si nje treg jo aktiv, por si nje treg i domosdoshem qe percakton ne menyre te ndjeshme zhvillimin e tregut te broadband, ne menyre te shkurter per LLU-ne eshte percaktuar se:

LLU:

- Eshte me e komplikuar se thjesht interkoneksioni ne rrjet;
- Kerkon veprime operacionale dhe komerciale;
- Kerkon investime;
- Mund te interferoje ne rrjetin egzistues;
- Kerkesat dhe nevojat duhen menaxhuar me kujdes;

LLU lejon nje furnizues te sherbimeve broadband te mundesoje sherbimet e broadband per klientet e vet te lidhur ne pajisje x DSL ne fille dyshe bakri te aksesuar ne rrjet.

LLU gjithashtu lejon operatorin LLU te bashkevendosin pajisjet qe zoterojne si operator i aksesuar ne rrjet. Zhvillimi i teknologjise DSL ka krijuar mundesi per bandwidth te larte qe varion nga 256 kbps deri ne 10 Mbps downstream, per ta dorezuar tek perdoruesi fundor qe bazohet ne DSL te aksesuar ne rrjetin e ndertuar me fille bakri.

LLU ka gjetur nje shtrirje ne rang nderkombetar, por duhet theksuar se:

- Operoret incumbent pengojne dhe nuk e realizojne ate ne menyre vullnetare;
- Implementimi LLU-se kerkon nderhyrje rregullatore te bazuar ne legjislacionin vendas.

Per rrjedhoje, operatorit incumbent i duhet kerkuar qe te mundesoje:

- Ngritjen e linjave te reja per sherbimin LLU dhe tarifimin te orientuar drejt kostove baze;
- Publikimin e ORU (Oferte Reference Unbundling) duke e shoqeruar me listen e cmimeve te miratuara nga rregullatori;
- Percaktimin e LLU si nje sherbim te ri ne listen e sherbimeve te ofruara;
- Nderhyrjen ne sistemin e pergjithshem te sherbimeve duke futur te gjitha sherbimet qe gjenerohen nga aksesit ne LLU;

Ne percaktimin e dimensionit te produkteve dhe sherbimeve te analizuara, sipas praktikave me te mira rregullatore eshte konkluduar se ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit duhen pershire:

- a) *Te gjitha vetefurnizimet ne tregun e shumices ne LLU qe mundesohen mbi rrjete egzistuese te broadband me teknologji baze bakrin;*
- b) *Te gjitha produktet dhe sherbimet qe furnizojne te tretet (ISP-te), ne tregun e shumices ne LLU qe mundesohen mbi rrjete egzistuese te broadband me teknologji baze bakrin;*

#### **Si konkluzion:**

- *Edhe pse ne kushtet e mungeses se tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur (LLU), hipotetikesht themi qe Altelekom zoteron 100% te tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin e hapur lokal (LLU).*

#### **Perfundim per FNT**

Bazuar ne kriteret e perdorura ne vleresimin dhe analizen per FN te Altelecom ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU), rezulton se faktoret themelore te analizuar dhe qe percaktojne FNT per Altelecom jane:

- Pjesa e tregut per Altelecom rezulton te jete 100% e tregut te mundshem hipotetik, bazuar ne arsyetimin e dhene me siper;
- Pamundesia e sipermarresve te tjere ne dublikimin e infrastruktures se rrjetit te Altelecom ne nje periudhe afatmesme;
- Avantazhet e ekonomive te densitetit; te ekonomise se shkalles; integritimit vertikal;
- Mungesa e fuqise kundervepruese te bleresve;
- Praktikate me te mira rregullatore ne vendet e tjera, justifikojne FNT te operatorit incumbent;

***AKEP, bazuar ne kete analize propozon qe:***

***Altelecom eshte operator me Fuqi te Ndjeshme ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit te tij nga nje vendodhje fikse duke perfshire aksesin e plote dhe te ndare.***

**Masat Rregulluese dhe detyrimet per Altelecom si operator me FNT ne tregun me shumice te aksesit ne broadband dhe LLU**

#### **Problemet e konkurences ne tregun e shumices te aksesit fizik ne rrjetin lokal**

Ne percaktimin e masave rregulluese per Altelecom edhe ne kete treg jane konsideruar problemet e mundshme qe pengojne konkurrencen, duke referuar edhe praktika pozitive ne

analizen e ketyre tregjeve si dhe ne identifikimin e problemeve qe pengojne nje konkurrence efektive.

Prezenca e operatoreve incumbent ne dy nivelet e tregjeve si pasoje e integritit vertikal te tyre, dominanca e tyre ne teresine sherbimeve qe bazohen ne rrjetin e tij, ben te mundur qe problemet qe shfaqen te jene te nje natyre qe kane lidhje me:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- tarifa shume te larta;
- diskriminim ne tarifa dhe cilesi;
- investim i tepert apo i manget;
- dhenia e sherbimeve me shporta (bashkimi i sherbimeve) etj

Probleme te tjera te cilat ne kushtet e nje dominance te tille jane prezente sipas te gjitha praktikave rregullatore jane:

- Mungesa e marreveshjeve te nivelit te sherbimit per afatet dhe cilesine e ofrimit aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur LLU (dy versionet full dhe shared)
- Diskriminimi i operatoreve te telekomunikacioneve (ofruesve te sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike) ne termat e sherbimit (cilesi dhe cmim);
- Mosdhenie e informacionit te mjaftueshem ne lidhje me prezencen gjeografike te rrjetit lokal, te pikave te aksesit si dhe te kapaciteteve teknike te mundshme;
- Identifikimi i kerkesave te arsyeshme per zgjidhje dhe percaktimi i kohes se nevojshme qe mundesoje zgjidhjen e ketyre kerkesave;
- Mungesa e nje dokumenti reference qe parashikon te gjitha rastet e zgjidhjes se kerkesave te arsyeshme dhe qe mundeson arrijten e marreveshjeve te bashkepunimit ndermjet operatorit incumbnt dhe sipermarresve te interesuar per akses fizik ne LLU;

### **Masat Rregulluese per FNT te Albtelecom per LLU**

Ne baze te parashikimeve te ligjit, neni 34, *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

Bazuar ne pershkrimin e problematikes se cituar me siper, si dhe referuar pervojave me te mira rregullatore, edhe pse aktualisht ne mungese te ketij tregu si treg aktiv, por duke qene te bindur se ne mungese te nderhyrjes nga AKEP, mundesia qe ky treg te zhvillohet ne menyre vullnetare nga Albtelecom nuk egziston, atehere AKEP gjykon se masat e nevojshme qe duhen propozuar ne kete draft analize per t'u vendosur ndaj Albtelecom, me reference ne parashikimet e Ligjit 9918, jane:

- 1.Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- 2.Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- 3.Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
- 4.Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- 5.Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Detyrimet e mesiperme midis te tjerave perfshijne:

- Publikimin e ofertes reference te aksesit ne rrjetin hapur lokal te Albtelecom per aksesin fizik ne LLU. Albtelecom do te duhet te zbatoje procedurat dhe rregullat per publikimin dhe permbajtjen e oferte reference te cilat jane te parashikuar ne Ligj dhe ne rregulloren e Akses dhe Interkoneksionit. Oferta reference duhet te permbaje te gjithë termat dhe kushtet e aksesit ne rrjet, perfs hire ato te sherbimeve ndihmese, termat dhe kushtet kryesore kontraktuale.
- Albtelecom duhet te mos diskriminoje midis operatoreve te ndryshem dhe midis operatoreve te tjere dhe klienteve, filialeve te veta dhe per kete do te duhet te kete;
  - *Detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur;*
  - *Detyrimi per te ofruar marrveshje te Nivelit te Sherbimit (service level agreement-SLA)*
  - *Detyrimi per te paguar kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimin te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort.*
  - *Detyrim per informacion dhe shpjegime te plota, bazuar ne rregullat dhe procedurat e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);*
  - *Detyrimin per percaktimin e kerkesave te arsyeshme dhe publikimin e tyre, si dhe dhenien e arsyeve te refuzimit (ne rast se ka) dhe publikimi e ketyre arsyeve;*
  - *Detyrimin per percaktimin e afatit kohor ne shqyrtimin e kerkeses se arsyeshme dhe realizimin e saj;*

**Kontrolli i tarifave te aksesit fizik ne LLU dhe orientimi ne kosto, si nje mase rregullatore propozuar per t'u vendosur ne kete treg.**

AKEP ka konsideruar si te nevojshme ne kushtet reale ku egziston zhvillimi ketij tregu, me qellim nxitjen e zhvillimit te ketij tregu, te kontrolloje:

a) tarifen e instalimit;

b) tarifen e pajtimit mujore te aksesit fizik ne LLU per (aksesin e plote dhe te ndare).

Keto tarifa nuk duhet te jene me te medha se niveli mesatar i vendeve te BE-se. Per metoden e rregullimit te tarifave, AKEP gjykon qe fillimisht, per nje periudhe 1 vjecare te aplikoje metoden e cmimit tavan apo maksimal, duke perdorur si reference nivelin mesatar te vendeve te BE, apo praktiken me te mire te vendeve te BE. Keto metoda jane te parashikuara ne nenin 57, pika 1/a dhe 2/a dhe 2/b.

Per periudhe afatgjate, AKEP gjykon se tarifat e orientuara ne koston eficiente te ofrimit te aksesit fizik ne LLU, eshte metoda me e mire e tarifimit, dhe metoda LRAIC e rekomanduar nga KE, eshte metoda me e mire per nxitjen e konkurrences efektive ne kete treg.

Detyrimi i orientimit ne kosto te tarifave te aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur eshte ne perputhje nenin 45 te Ligjit, si edhe nenin 59/2 per perdorimin nga AKEP te metodave te llogaritjes se koston efciente te pavaruara nga operatori.

AKEP pas marrjes se rezultateve dhe rekomandimeve te ketij projekti, gjykon se do jete nevojshme te zhvilloje nje konsultim publik per marrjen nje vendimi per rregullimin e tarifave te gjitha sherbimeve qe jane perfshire ne kete projkt, nder te tjera edhe ofrimi i LLU-se.

## I. HYRJE

### II.1 Panorame e përgjithshme e zhvillimit të broadband në Shqipëri dhe BE-27

Aksesi në Internet me brez të gjerë sot është faktori kryesor i konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe sociale të një vendi. Ndarja e informacionit me shpejtësi të madhe, rrit prodhimin, ndihmon tregun duke sjellur risi në zhvillimin ekonomik-shoqëror. Për të pasur të gjitha avantazhet e Internetit, konsumatorët duhet të jenë në gjendje të dërgojnë dhe të pranojnë të dhëna me shpejtësi të madhe. Kjo është ajo çfarë ofron aksesi me brez të gjerë.

Teknologjia e përdorur gjerësisht në vendet e BE-së, teknologjia DSL vazhdon të përmirësohet, duke ofruar tashmë shpejtësi të të dhënave të tilla që konsiderohet si një shpejtësi e mjaftueshme dhe është një përmirësim i madh ndaj shpejtësisë që mundesonte aksesi në dial-up. Shpejtësitë e disponueshme me linjat e bakrit nëpërmjet x DS, pavarësisht avantazheve që kanë sjelle në një rritje të shpejtë të penetrimit të aksesit në broadband, studime të bëra në këto drejtim po referojnë idene se jemi afër mundësisë së kufizimit të rritjes të mëtejshme të tregut në shërbimet e të dhënave me shpejtësi të madhe. Kjo është arsyeja pse shumë vende të BE-së tashmë kanë politikë me theks të veçantë në “new generation access” që i referohet mënyrave të ndryshme të përdorimit të fibrave optike në vend të, ose bashkë me telat e bakrit.

### Aksesi me brez të gjerë dhe ofruesit e shërbimit broadband në Shqipëri

Për të përshkruar situatën në Shqipëri se pari duhet të sjellim në vëmendje panoramën e sektorit të telefonisë fikse, si një nga rrjetet që mundeson me lehtë penetrimin e broadband në një kohë të shkurtër bazuar në teknologjinë DSL.

Krijimi i mundësive për të përdorur Wimax si dhe mundësimin që operatorët e lëvizshëm të kenë akses në spektrin UMTS. Të dy këto elemente janë në fokusin e politikave për shvillimin e broadband në Shqipëri të cilat mundesojnë futjen e teknologjive të aksesit me brez të gjerë siç është 3G dhe Wimax.

Politikat e qeverisë janë që të lejohet dhe të inkurajohet përdorimi i çdo teknologjie e cila do të sjellë një gamë më të gjerë të zgjedhjes, cilësi dhe çmime më të mira në treg.

Numri i përdoruesve të telefonisë fikse, apo linjave telefonike që përfundojnë në vendodhjet fikse (adresat) e përdoruesve të tyre, dhe mbulimi me rrjet dhe kapacitete transmetuese i territorit, luajnë një rol të rëndësishëm në mundësimin e aksesit në broadband duke shfrytëzuar kapacitetet e rrjetit fiks. Numri i përdoruesve të telefonisë fikse deri në fund të vitit 2009 vlerësohet të jetë afërsisht (363 mijë). Norma e penetrimit, apo numrit të përdoruesve për 100 banorë, të linjave fundore të telefonisë fikse, në fund të vitit 2009 është (11.5%), e cila është shumë më e ulët se mesatarja në vendet e BE (45%) dhe të rajonit, si dhe shumë më e ulët se norma e penetrimit të shërbimeve celulare në Shqipëri

Sipas regjistrimit të sipërmarrësve në AKEP kanë njoftuar për ofrimin e shërbimit të internetit rreth 90 sipërmarrës, por rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë aktiv akoma në ofrimin e këtij shërbimi. Disproporcioni ndërmjet numrit të madh të operatorëve që kanë njoftuar për ofrimin e këtij shërbimi si dhe numrit real të tyre që janë aktiv në treg vjen si rezultat i

liberalizimit të ligjit në ofrimin e shërbimeve në tregun e komunikimeve elektronike në RSH, Ligji 9918 dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në RSH”.

### **Aksesi me brez të gjerë në BE- 27**

Aktualisht në BE janë më shumë se 100 milion lidhje në brez të gjerë dhe rreth 85% të tyre ofrohen nëpërmjet teknologjisë DSL. Gjithashtu, do të ishte vlerësim pothuajse i saktë të thuhet se në BE çdo shtëpi që dëshiron një linjë telefonike tashmë e ka, dhe pothuajse të gjitha këto linja ofrohen me tela bakri. Pothuajse të gjitha shtëpitë në BE mund të kenë akses me brez të gjerë ose centralet telefonike lokale mund të pajisen për të ofruar brezin e gjerë. Prandaj pajisja me DSL nuk është një pengesë serioze.

Në këtë përfundim përfshihen edhe dy çështje:

- 1) Deri tani, roli i teknologjive të tjera me brez të gjerë (që nuk ofrohen me DSL) në BE ka qenë të stimulojnë operatorin inkumbent të ofrojë DSL më të shpejtë.
- 2) Ritmi i rritjes së penetrimit të brezit të gjerë tani përcaktohet kryesisht nga kërkesat, siç janë:
  - Kostoja ekonomike e këtyre shërbimeve;
  - Perfitimi i shërbimeve të reja të mundësuar nëpërmjet brezit të gjerë, si “triple-play” paketa me tarifa të perballueshme nga përdoruesi fundor;

Në shumicën e vendeve të BE-së këto janë gjërat e vetme të cilat mund të influencojnë shpejtësinë me të cilën penetrimi i Internetit me brez të gjerë do të arrijë të gjitha familjet të cilat e kërkojnë këtë shërbim. Tregu tashmë ka arritur pikën në të cilën autoritetet e BE-së e kanë përqëndruar vëmendjen në garantimin e shërbimit broadband në zona të vështira.

## II.2. Percaktimi i sipermarresve me Fuqi te Ndjeshme ne Treg

### I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918) qe hyri ne force me 26.06.2009, ne nenin 1 te tij, percakton se Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave:

AKEP-i nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve

elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me nevoja të veçanta, që kundrejt tarifave ***në çdo rast jo më të larta se tarifat mesatare të vendeve të BE-së***, mbi bazën e përzgjedhjes të përfitojnë maksimalisht shërbime alternative, cilësore dhe në përputhje me standardet e miratuara nga AKEP-i;

b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;

ç) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;

d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;

dh) për të nxitur investimet efiçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e anlizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermrresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e



Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja). Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 18 tregjeve per tu analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimi per te kryer analizen e tre kritereve per tregjet qe nuk jane pjese e Rekomandimit te Komisionit European, datë 11 Shkurt 2003.

Ligji 9918 eshte ne linje me direktivat e KE te vitit 2003 dhe metodologjia e analizes se tregjeve e percaktuar ne Ligj dhe ne Rregullore, percakton se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimet e Komisionit European.

Disa nga Rekomandimet dhe udhezimet e KE-se te marra ne konsiderate nga AKEP jane si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhezimi i KE)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

## **II.Procesi i Konsultimit**

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne RSH”, parashikon ne Nenin 35 te tij proceduren e keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke vendosur si afat periudhen kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara. Ne kete menyre, AKEP mirepret komentet e paleve te interesuara deri 60 dite nga data e publikimit ne faqen e Internetit te AKEP, per perfundimet ne lidhje me FNT dhe detyrimet e propozuara nga AKEP per FNT. Komentet e paleve te interesuara do te publikohen nga AKEP, se bashku me dokumentin final te analizes se tregut dhe vendimet per FNT. Ne cdo seksion ka pyetje per komente nga palet e interesuara, por palet mund te japin komente per cdo pjese te ketij dokumenti.

Ne rast se ka pale qe nuk do te deshironin te identifikoreshin ne publikimin e komenteve nga AKEP, apo pjese te komenteve te cilat i konsiderojne konfidenciale, keto pale duhet te bejne nje shenim per keto raste. AKEP do te gjykoje se cilat prej fakteve apo te dhenave kane natyre konfidenciale.

### **III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences**

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne RSH”, AKEP-i do të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Do të zbatohet Memorandumi i Mirëkuptimit (Nr. Prot. 1566/1, datë 29.08.2007) ndermjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe në veçanti “Neni 6”, ku flitet per përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

Ne kete process do te perfshihet konform percaktimit te mesiperm ligjor si dhe te marreveshjes se bashkepunimit edhe Autoriteti i Konkurences, komentet e te cilit serish do te jene te perfshira ne versionin final te analizes, pas konsultimit publik.

### **IV. Struktura e Dokumentit**

Ky dokument permban analizen e tregjeve te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike LLU si dhe te aksesit ne tregun e shumices ne broadband dhe konkretisht tregjet nr.14 dhe 15 te Rregullores:

- 1) Tregun me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.
- 2) Tregun me shumice te aksesit broadband .

Ne baze te parashikimeve te Rregullores, analiza permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates per te analizuar konkurrencen ne keto tregje dhe nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg, duke perdorur kriteret e percaktuara ne nenin 33 te Ligjit si dhe udhezimin e KE
- analizimin e problemeve ne tregjet ne te cilat nuk ka konkurrence efektive apo ku ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg
- detyrimet per operatoret me fuqi te ndjeshme ne treg

### **V. Perkufizimi i tregut perkates**

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Ne Analizat e meparshme te tregjeve (2006, 2007 dhe 2009) ERT (AKEP) ka perdorur perkufizimin e tregut perkates te dhene ne Rregullore 2005, perkufizim i i marre nga Ligji per Mbrojtjen e Konkurences:

*Treg perkates- jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky perkufizim eshte i ngjashem me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44 <sup>1</sup>, udhezim i perdorur nga ERT edhe ne Analize 2007. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore, AKEP ne kete Analize do te perdore te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analize 2007, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

### **Parimi i monopolistit hipotetik**

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses-konsumatorët do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

---

<sup>1</sup> According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

### ***Zevendesimi ne anen e kerkeses***

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorët te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

### **Zevendesimi ne anen e ofertes**

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efkti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rrise çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjetër, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjetër.

## **VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese**

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

*Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.*

Ky perkufizim është pothuajse i njëjte me perkufizimin e Direktives Kuader të KE 2002, neni 14<sup>2</sup> (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar. Perkufizimi i dominancës së bashkuar i dhënë në nenin 33 është si vijon:

*Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.*

Për përcaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, siç theksohet dhe në pikat 79 dhe 98 të Udhezimit të KE, kriteret e përdorur duhen marrë të gjithë në konsideratë dhe në kombinim me njëri tjetrin dhe jo në mënyrë të veçantë për secilin kriter me vetë, pasi evidenca e kriterëve të veçantë mund të mos jete përcaktuese e FNT.

Analiza për FNT është një analizë e cila merr në konsideratë zhvillimet e kaluara dhe njëkohësisht tendencën për të ardhmen (forward looking), pasi mungesa e konkurrencës në të kaluarën nuk do të thotë që një treg nuk ka tendencë për të qenë në konkurrencë në të ardhmen. Në këtë mënyrë Analiza krahas shqyrtimit të kriterëve për vlerësimin e konkurrencës efektive në treg në të kaluarën, bën vlerësimin se si pritet të evoluojë tregu në të ardhmen. Analiza kryhet për të shqyrtuar nëse një treg përket vlerësohet të jete në konkurrencë efektive në një periudhë të pakten 2 vjeçare, dhe mungesa e konkurrencës efektive është barazvlefshme me ekzistencën e fuqisë së ndjeshme në treg, prej një ose më shumë sipërmarrësish.

Ekzistenca e FNT do të thotë që në treg ka probleme të cilat identifikohen dhe në bazë të problemeve të evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrime për tu zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT. AKEP në bazë të nenit 34, ka detyrimin që në rast të gjetjes së FNT në një treg përket të vendosë një disa apo të gjitha detyrimet e cilesuara në nenet 39-45 dhe nenin 56 të Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese për FNT duhet të marrë në konsideratë objektivat rregullatore të përcaktuara në Ligj.

---

<sup>2</sup> *‘an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers’*

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre.

### **III. TREGU AKSESIT NE BROADBAND DHE PERSHKRIMI I TIJ**

#### **III.1 Pershkrimi i Tregut te Pakices te aksesit ne Broadband**

Per te bere pershkrimin e ketij tregu duhen konsideruar nje sere faktoresh, por do te arsyetohet kryesisht bazuar ne numrin e kerkesave per produkte dhe sherbime ne kete treg si dhe mundesia e zevendesimit te ketyre kerkesave, e pare ne dy kendeveshtrime:

- a) *Ne mundesine e zevendesimit te kerkesave duke marre ne konsiderate funksionin e produkteve dhe sherbimeve sipas karakteristikave teknike te tyre.*
- b) *Mundesia e zevendesimit te ketyre kerkesave nepermjet ofertuesve te ndryshem.*

Arsyetimi konsiston ne se:

- a) *Aksesi ne Narrowband dhe Broadband bejne pjese ne te njejtin treg te pakices.*
- b) *Te gjitha teknologjite qe mundesojne akses ne broadband bejne pjese ne te njejtin treg te pakices.*
- c) *Pajtimtaret e te dy kategorive (biznes+familjare) bejne pjese ne te njejtin treg te pakices.*

Cdo perdorues fundor, para se gjithash per te perfituar nga sherbimet qe ofrohen duhet te kete akses ne rrjetin nepermjet te cilit ofrohen keto sherbime, dhe si i tille ky akses realizohet ne lidhjet ne pikat fundore, per te cilat eshte e nevojshme te sjellim perkufizimin e cituar si:

**"Pika fundore e rrjetit"** *eshte pika fizike ne te cilen nje pajtimtar ka akses ne rrjetin e komunikimeve publike. Ne rastin e rrjeteve, qe perfshijne komutimin ose rrugezimin pika fundore e rrjetit identifikohet si nje adrese specifike e rrjetit e cila mund te lidhet me numrin ose emrin e nje pajtimtari. (neni 3, paragraf 31, Ligji Nr.9918, date 19.05.2008)*

Sherbimi i aksesit apo linjes se aksesit mund te ofrohet vetem nga operatore te autorizuar per ofrimin e sherbimeve publike, te cilet ndertojne infrastrukturen e nevojshme per te lidhur perdoruesit nga vendodhje fikse ne rrjetin e tyre.

*Ne menyre te perkufizuar themi qe:*

*Sherbimi « akses ne broadband » duhet te kuptohet si sherbimi i ofruar perdoruesve fundore, nepermjet lidhjes se pikave fundore me rrjetin qe ofron kete sherbim, nepermjet te cilit realizojne kryerjen e nevojave dhe sherbimeve qe mundeson ky rrjet.*

Sipas ketij pershkrimi, aksesit ne broadband mundesohet ne keto menyra:

- d) *akses ne broadband duke u mbeshtetur mbi nje rrjet publik telefonik fiks nga nje vendodhje fikse.*
- e) *Akses ne broadband duke shfrytezuar linja kabllore (infrastrukture te ngritur nga ana e ISP-ve)*
- f) *Akses ne broadband duke shfrytezuar teknologji te tjera te cilat bazohen ne perdorimin e frekuencave*

### **Teknologjite qe e mundesojne aksesin ne broadband**

Aksesi ne broadband ne nivelin e pakices ofrohet nga nje numer i konsiderueshem ofruesish te sherbimit te internetit (aktiv rreth 45, kurse autorizuar per te ofruar kete sherbim rreth 90). Teknologjite qe mundesojne akses ne broadband jane te ndryshme, por pavaresisht teknologjive

te perdorura eshte e nevojshme te arsyetohet ne lidhje me nje grup karakteristikash funksionale qe te permbledhura do te bazoheshin mbi:

*Platformat mbi te cilen mundesohet akses ne broadband mbeshtetet kryesisht ne:*

- Kabllore
- FWA (Fixed Wireless Access)
- x DSL
- Fiber Optike
- Satelitore

*Dhe pavaresisht se cila prej tyre perdoret, dallimi ndermjet tyre percaktohet ne:*

- ❖ *Karakteristikat funksionale te lidhjes:*
  - Download
  - Upload
- ❖ *Tarifa Mujore*
- ❖ *Tarifa e Instalimit*

Dy prej ketyre teknologjive (x DSL dhe Kabell Modem) perdoren ne shfrytezimin e rrjeteve te ngritura dhe ne te shumten e rasteve egzistojne ngjashmeri qofte ne strukturen e cmimit por edhe te karakteristikave funksionale te tjera per te dy teknologjite x DSL dhe Kabell Modem ne Broadband. Akses ne broadband ne tregun e pakices mundesohet nga te gjitha llojet e teknologjive te listuara me siper, ndaj ne pershkrimin e ketyre teknologjive si dhe prezencen e tyre ne tregun e pakices, do te mbeshtetemi kryesisht ne numrin e kerkesave qe origjinohen ne kete treg te cilat gjejne zgjidhje nga ofertues te ndryshem te bazuar ne teknologjite e listuara.

**“Akses ne broadband”** ne kendveshtrimin e furnizuesit, ne tregun e pakices mundesohet ne dy menyra:

- 1) *Akses ne broadband te bazuar mbi vetefurnizimin;*
- 2) *Akses ne broadband te mundesuar nga “te tretet”, qe kane akses ne tregun e shumices.*

Te dy menyrat e aksesit ne tregun e pakices mund te ofrohen bazuar ne te gjitha teknologjite e cituara me siper.

*Ndaj ne kete linje te arsyeturi e konsiderojme te nevojshme te konsultohet me tregun pyetja ne se:*

- **A eshte i mundur te ofrohet „aksesi ne broadband“ per perdoruesin fundor ne tregun e pakices sipas menyres se furnizimit si dhe bazuar ne teknologjite e cituara me siper sipas pershkrimit te bere?**

**Ju lutem jepni arsyetimin tuaj ne lidhje me kete percaktim te bere nga AKEP.**



### III.2 Pershkrimi i aksesit ne broadband ne tregun e pakices sipas teknologjive.

#### Aksesi ne broadband bazuar ne teknologjine x DSL


Duke arsyetuar per te dy teknologjite (x DSL dhe Kabllore) te konsideruara si te ngjashme ne lidhje me infrastrukturen e tyre si dhe mundesine e futjes ne tregun e pakices te ofruesve te rinj, natyrisht qe eshte e nevojshme te vleresojmë dy elemente:

- a) *Se pari duhen konsideruar kostot efektive per te hyre ne treg;*
- b) *Se dyti duhet pare mundesia e aksesit duke shfrytezuar rrjetet e ngritura nga operatore egzistues dhe a do te mundesonin keta te fundit nje gje te tille per hyrjet e reja ne kete treg;*


Aksesi ne sherbimin e internetit duke u bazuar ne teknologjine x DSL ofrohet nga disa operatore ne tregun shqiptar, por peshen kryesore te ketij sherbimi e ze Albtekom, kjo edhe nga fakti qe eshte trashegimtar i nje infrastrukture te ngritur ne shkalle kombetare. Sipas evidentimit te te dhenave per sherbimin e internetit bazuar ne teknologjine x DSL, rezulton qe ky sherbim ze rreth 92% te sherbimit te aksesit ne broadband te bazuar ne te gjitha teknologjite. Duke e vleresuar si nje teknologji qe ze peshen kryesore, faktoret baze qe kane ndikuar ne nje rritje te shpejte te aksesit ne broadband te bazuar ne x DSL jane:

- a) *Lehtesia per t'u aksesuar duke shfrytezuar aksesin ne rrjetin e telefonise fikse;*
- b) *Shpejtesia e mjaftueshme per te mundesuar perpunimin e aplikacioneve te ndryshme;*
- c) *Lehtesia ne perdorim;*
- d) *Siguria qe ofron, pasi duke perdorur linjen telefonike qe eshte personale, nuk lejon interferimin e perdoruesve te tjere ne informacionin personal te cdo klienti.*
- e) *Funksionaliteti, pasi shërbimi ADSL ofron mundësinë për përdorimin e shërbimit nga disa përdorues në të njëjtën kohë. Kjo favorizon klientë të tillë si institucione, rezidenca, shkolla dhe ndërmarrje që kanë nevojë aksesit për disa përdorues;*
- f) *Kerkesat teknike per ADSL te permbledhura jane:*
  - 1) *Një ADSL kërkon një linje telefonike të gatshme nga rrjeti fiks i telefonise;*
  - 2) *Një modem ADSL-je, i cili të jetë kompatibël me shërbimin ADSL;*
  - 3) *Një splitter (ndares) për telefonin ose shërbimin faks;*
  - 4) *Një kompjuter me portë Etherneti ose USB dhe procesor i thjeshte;*
  - 5) *Teknologjia x DSL funksionon ne kete menyre:*


Zeri perdor vetem nje fraksion te vogel te nje frekuence qe kalon ne kabell bakri. Sistemet DSL lejojne transmetimin e njekohshem te zerit dhe te dhenave duke perdorur filtrat per te ndare zerin nga te dhenat. Duke perdorur frekuenca jashte zerit ( ADSL) ose dhe duke perdorur te gjithë diapazonin e frekuencave ( SDSL), mund te rritet ne menyre te konsiderueshme bandwidth-i.Nje pajisje ne rrjet DSLAM (DSL Access Multiplexer) lidh shume perdorues DSL ne nje shpejtesi te larte ne “backbone line” duke perdorur teknikat e multipleksimit. DSL eshte opsioni me kosto efektive me te mire krahasur me lidhjet e tjera broadband sepse eshte ne gjendje te shfrytezoj avantazhet e infrastruktures telefonike ekzistuese per zerin dhe per te dhenat.



**Fig1. Pesha ne treg sipas teknologjive qe mundesojne akses ne broadband**



**Fig 2. Pesha ne treg e operatoreve kryesore per teknologjine x DSL**



**Fig 3. Numri linjave ADSL per Albtelekom dhe te tjeret ne tregun e broadband**

Albtelekom si operatori me peshen kryesore ne ofrimin e sherbimit ADSL, ne fund te vitit 2009 ofronte akses ne teknologjine ADSL, gjithesej 52 000 linja akses, rreth 75 % te linjave te aksesit te ofruara me teknologjine x DSL. Ndaj si nje ofruer kryesore ne kete sherbim, ne menyre te permbledhur paketa e ofruar me sherbimet sipas kapacitetit si dhe tarifat perkatese nga Albtelekom jane:

### **Albtelecom**

Paketat “ADSL” te ofruara nga Albtelecom

- ADSL me shpejtësi 512/128 Kbps dhe download limit 1 Gbyte/muaj
- ADSL me shpejtësi 512/128 Kbps dhe download "Pa Limit"
- ADSL me shpejtësi 1024/256 Kbps dhe download "Pa limit".
- ADSL PRO me shpejtësi 1024/256 Kbps me IP Statik dhe download "Pa limit"
- ADSL PRO me shpejtësi 2048/512 Kbps me IP Statik dhe download "Pa limit"
- ADSL PRO me shpejtësi 4096/768 Kbps me IP Statik dhe download "Pa limit"

### Tarifat e Shërbimit ADSL

Kategoria e Shërbimit ADSL	Shpejtësia	Tarifa Instalimit	Tarifa Mujore	Mbipagesa
ADSL	512/128 Kbit/s	3,325 Lekë	999	0.50 lek/ MByte
	Kufizimi 1 GByte		Lekë/muaj	
ADSL Unlimited	512/128 Kbit/s		2,499 Lekë/muaj	
ADSL Unlimited	1024/256 Kbit/s	2,999 Lekë/muaj		
ADSL PRO	1024/256 Kbit/s	4,158.4 Lekë	4,999 Lekë/muaj	
	Static IP			
ADSL PRO	2048/512 Kbit/s		7,499 Lekë/muaj	
	Static IP			
ADSL PRO	4096/768 Kbit/s		9,999 Lekë/muaj	
	Static IP			

\* Tarifa e transferimit për shërbimin ADSL është e njëjtë me tarifën e instalimit

\*\* Tarifat janë pa TVSH

Nder ofruesit e tjere te x DSL ne treg jane operatoret Abissnet, Abcom, ASC, Primo etj. Te cilet te gjithë se bashku zene rreth 25% te ofrimit te ketij shërbimi te bazuar ne teknologjine x DSL.

Ne teknologjine x DSL perfshihen si: ADSL, ADSL 2+, SDSL,

### Konkluzion per teknologjine x DSL

*Pavaresisht shërbimeve te ndryshme qe bazohen ne teknologjine x DSL, ne fund te fundit aksesit ne tipe te ndryshme te teknologjise x DSL varet nga kerkesat e perdoruesve per me shume cilesi, shpejtësi dhe llojshmeri shërbimesh.*

**Aksesi ne broadband bazuar ne rrjete kabllore**

Teknologjia kabllore eshte nje nder teknologjite qe ofron avantazhe ne transferimin e te dhenave duke mundesuar lidhje direkte sipas kapacitetit te kontraktuar (kualitet ne transferimin e te dhenave). Perdoruesit lidhen nepermjet kabellit koaksial (rrjet fibre koaksial) dhe jane te njohura ne terminologjine e perditeshme si lidhje te dedikuara. Kryesisht perdoren nga kompani private, banka, institucione shtetore, televizione etj, dhe nje nder avantazhet kryesore eshte kualiteti i larte ne tranferimin e te dhenave.

Aksesi ne internet broadband bazuar ne rrjete kabllore lejon transferimin e te dhenave ne menyre te ngjashme me teknologjine ADSL e cila eshte e bazuar mbi tela bakri te ciftuar, teknologji te cilen e kemi detajuar ne pershkrimin e bere me siper.

Sipas te dhenave te evidentuara nga ofruesit e sherbimit te internetit, rezulton qe ka lidhje te dedikuara deri ne fund te vitit 2009 afersisht 1800 lidhje te tilla. Pavaresisht ngjashmerise ne anen funksionale ndermjet ketyre dy teknologjive (Kabell Modem dhe DSL), rezulton se ne tregun e pakices jane te diferencuara persa i perkete cmimit per te kontraktuar te njejtin kapacitet. Por ne ndryshim nga teknologji te tjera te krahasuara me teknologjine DSL, ne se kjo teknologji nuk do te ndjente presionin e cmimit dhe karakteristikave funksionale, atehere do te konsiderohet si me e mundshme per te bere zevendendesimin ne tregun e pakices.

Lidhja e dedikuar eshte nje lidhje e disponueshme 24 ore ne dite midis dy vendndodhjeve te caktuara nga perdoruesi ose kompania. Keshtu linja e dedikuar konsiderohet si linje private qe garanton nje bandwidth konstant ne cdo kohe. Nese ka akses ne internet me lidhje te dedikuar shpejtesia e internetit eshte konstante ne cdo kohe, ndersa shpejtesia e nje lidhje interntei "share" ndryshon ne varesi te numrit te perdoruesve qe e perdorin njekohesisht duke ndryshuar edhe karakteristikat funksionale te download apo upload ne te njejtin moment.

Aksesi ne broadband bazuar ne lidhje te dedikuara kabllore, ofrohet nga disa sipermarres ne treg si: Albtelecom, Abcom, Abissnet, Primo, ASC, etj. Per te mundesuar aksesin nepermjet lidhjes se dedikuar kabllore, pervec karakteristikave teknike te paketes se ofruar duhen konsideruar edhe tarifa mujore dhe tarifa e instalimit e cila paguhet vetem njehere ne momentin e instalimit.



### **Internet i Dedikuar ne Albtelecom**

Shpejtësia	Tarifa Mujore (Lekë/Muaj)	Tarifa Instalimit (Lekë)	
		ALBtelecom	Klienti
64 Kbit/s	6,500	54,000	21,600
96 Kbit/s	8,400		

128 Kbit/s	11,000		
192 Kbit/s	14,300		
256 Kbit/s	16,200		
384 Kbit/s	21,500		
512 Kbit/s	26,100		
768 Kbit/s	35,500		
1 Mbit/s	48,300		
1.5 Mbit/s	65,700		
2 Mbit/s	89,300		
3 Mbit/s	124,000		
4 Mbit/s	173,000		
6 Mbit/s	248,000	90,000	
8 Mbit/s	346,000		
12 Mbit/s	496,000		
16 Mbit/s	692,000		
24 Mbit/s	992,000		
34 Mbit/s	1,384,000		

- *Tarifa e një adrese IP reale është 300 Lekë/muaj*
- *Tarifat janë pa TVSH*

Operatori Albtelecom ofron akses ne broadband bazuar ne lidhje te dedikuar, sipas te ciles ky lloj aksesi Internet i Dedikuar është një shërbim data internet network që lidh rrjetet kompjuterike me rrjetin Internet. Kapacitei qe siguron ky lloj aksesi është i siguruar me një ndërfaqes me shpejtësi 10 Mbps ose 100 Mbps në lidhjen fizike Ethernet 10/100 Base, si dhe cdo lidhje individuale siguron kapacitetin e kërkuar për të mbartur trafikun në “downstream” dhe “upstream”. Avantazhi qe sjell ky lloj aksesi eshte se kapaciteti i kërkuar është plotësisht në dispozicion të klientit dhe nuk varet nga numri i përdoruesve në një moment të caktuar. Gjeografikisht Albtelecom është në gjendje të ofrojë shërbimin e Akses Internet i Dedikuar, në çdo pikë ku kërkohet nga klienti.

**Avantazhet qe ofrohen nga Albtelecom ne kete lloj aksesi permbliidhen ne:**

- Lidhja është bazuar në standardin Ethernet, që është një teknologji e njohur nga stafi teknik.
- Ekonomikisht zvogëlon koston e pajisjeve tek klienti.
- Shërbimet dhe mirëmbajtja janë të centralizuara.
- Lidhja siguron deri në 100Mbps midis Albtelecom dhe pikës hyrëse të klientit.

- Shkallëzimi i kapaciteteve të ofruara do të thotë “ju paguani për sa keni nevojë”.
- Mundëson ofrimin e shërbimit në të gjithë Shqipërinë, bazuar në një rrjet dixhital të Albtelecom.

Ne ofrimin e Internet te Dedikuar ka edhe opearore te tjere dhe konkretisht:

Operatori ABCOM ofron tre paketa baze:

- Paketa baze me kapacitet 512/128 kbit/s; dhe tarife nga 1500 – 1900 leke ne muaj ne varesi te periudhes se kontraktimit;
- Paketa optimal me kapacitet 256/128 kbit/s; dhe tarife nga 2000 – 2500 leke ne muaj ne varesi te periudhes se kontraktimit;
- Paketa e avancuar me kapacitet 1 Mbit/128 kbit/s; dhe tarife nga 2700 – 3500 leke ne muaj ne varesi te periudhes se kontraktimit;

Ne treg ka edhe ofrues te tjere te aksesit ne broadband nepermjet teknologjise kabllore dhe se paketat e ofruara sipas kapacitetit dhe karakteristikave ne termat teknike dhe te cmimit jane te krahasueshme me referencat e dhena per Albtelekom dhe Abcom.

### **Aksesi ne broadband bazuar mbi Linjat me Qera**

Aksesi ne broadband nepermjet teknologjise se linjave me qera eshte nder akseset qe lejon tranferimin e te dhenave ne kualitet me te larte, por kostoja per te mundesuar nje akses te tille eshte me larte, duke bere ne kete menyre te mundur qe te jete nje mundesi aksesit kryesisht per kompani biznesi, institucione bankare dhe jo-bankare (per te cilat ka rendesi te madhe kualiteti) si dhe perballojne nga ana ekonomike nje akses te tille. Eshte perfunduar edhe analiza e tregut per linjat me qera, ne te cilen eshte analizuar ne detaje per mundesine e aksesit ne broadband duke shfrytezuar kete teknologji. Ndaj e thene ne menyre te permbledhur, duke konsideruar karakteristikat ne termat e cmimit, teknologjia e linjave me qera nuk perfaqeson zevendesueshmeri te plote te teknologjise DSL per te cilen kemi bere nje trajtim te hollesishem me siper. AKEP sapo ka perfunduar analizen e linjave me qera, ne te cilen Albtelekom eshte shpallur OFNT ne tregjet e trajtuara ne analize.

### **Aksesi ne broadband bazuar ne Fibren Optike**

Fibra optike eshte nje teknologji e re, ajo konverton te dhenat ne impulse drite dhe i dergon ne linje, ne destinacion impulsi i drites konvertohet ne te dhena. Per shkak te humbjeve te vogla ne linje dhe transmetimi i te dhenave behet nga impluset te drites, fibra mund te perdoret per distanca te medha. Bandwidth i fibres mund te jete 100Mbps, 1Gbps,10 Gbps etj, por kjo varet nga aksesoret qe vendosen ne linje. Nuk ka interferenca ne linjat me fiber optike. Permasat fizike te fibres jane shume te vogla cka lejon dhe lehtesi ne instalimet e saj, per kapacitete te medha.

Fibra Optike eshte nje nder teknologjite qe sot ka nje shtrirje gjithnje e ne rritje e cila mundeson kualitet te larte ne transferimin e te dhenave, duke rritur interesin per te patur akses ne broadband bazuar ne kete teknologji.

Nevojat per te patur nje kapacitet te larte si dhe kualitet me perdorimin e produkteve qe te mundeson akses ne broadband, ben te mundur rritjen e vazhdueshme te kerkesave te perdoruesve per te patur akses ne kete teknologji.

Fibra Optike lejon tranferim te shpejtesise me larte se teknologjia DSL, e cila ben te mundur edhe furnizimin e sherbimeve me kualitet te larte si psh (stacione televizive etj), por natyrisht me nje strukture cimi te ndryshme nga teknologjia ADSL. Por duke konsideruar karakteristikat ne termat funksionale dhe te cmimit, duhet thene qe influencia qe mund te kete fibra optike ne tregun e pakices, duke vleresuar kualitetin ne plotesimin e nevojave te perdoruesve dhe per rrjedhoje do te konsiderohet si nje nder teknologjite me influence ne rritjen e konkureses ne tregun e pakices. Origjinimi i kerkesave ne tregun e pakices do te kerkoje permbushjen e tyre ne tregun e shumices dhe per pasoje ne vijim do ilustrohet mundesia e zevendesimit te kesaj teknologjie qe mundeson akses ne tregun e shumices nga teknologji te tjera qe mundesojne sherbime ne tregun e shumices te aksesit ne broadband.

Ofruesit e sherbimit te internetit ne tregun e komunikimeve elektronike, kane tendencen qe rrjetet e tyre t'i bazojne ne kete teknologji ne nje pjese te konsiderueshme te tyre. Kjo perforcohet edhe nga te dhenat e pyetesorit te cilat jane evidentuar ne fund te vitit 2009.


### **Aksesi ne broadband bazuar ne rrjetin GSM (aksesi ne mobile)**

Aksesi i realizuar ne broadband ka mundesuar nje rritje te shpejte te penetrimit duke shfrytezuar teknologjine GPRS, EDGE. Duhet theksuar qe EDGE eshte teknologji me e avanacuare se GPRS duke mundesuar shpejtesi dhe kapacitet me te larte.

Perdoruesi fundor qe aksesohet ne broadband duke shfrytezuar rrjetin mobile e realizon kete ne dy menyra:

- a) Nepermjet Sim Card;
- b) Nepermjet Card Modem;

Aksesi ne broadband nepermjet rrjetit mobile ka avantazhet dhe disavantazhet e veta dhe ne nje pershkrim te pergjithshem mund te themi qe:



**Fig.4** Perdorues interneti bazuar ne rrjetin GSM (klasifikuar ne familjare dhe biznes)

Perdorimi i internetit ofrohet nga tre operatorët mobile, ndaj ne vijim do te pershkruajme shkurtimisht shërbimin e aksesit ne internet nga sejcili prej operatorëve mobile, duke referuar karakteristikat kryesore per sejcilin si dhe cmimet e ofruara.

### **Eagle Mobile;**

Duke shfrytezuar rrjetin mobile, teknologjine GPRS, EDGE etj, ne perdorimin e internetit ofrohet kapaciteti i mjaftueshem per te perdorur faqe web te ndryshme, per te shikuar posten elektronike.

Aksesi ne internet nepermjet celularit te tyre, realizohet pasi te jene kryer te gjitha konfigurimet e nevojshme per kete shërbim.

Teknologjia EDGE mundesohet nga operatori mobile Eagle Mobile dhe ka shtrirje kombetare. Kapaciteti dhe cmimi i ofruar per perdoruesit e internetit bazuar ne kete teknologji eshte 0.30 (leke) me TVSH për 10KB. Ky shërbim ofrohet per te gjithë abonentet me kontrate dhe me parapagese.

Shërbimi i internetit nga Eagle Mobile ofrohet me ane te SIM Card si dhe te Card Modem per kompjuterin (Lap Top), duke e ofruar per klientet qe deshirojne te perdorin internet me ane te teknologjise EDGE, me kapacitet deri 384 kbps (download) dhe 48 kbps (upload). Cmimi per Modem USB eshte 12.500 leke, dhe Modem USB mund te aktivizohet shume thjesht ne Laptop ose PC.

Aktivizimi i shërbimit te Internetit ne Laptop ose PC-in mund te behet duke vendosur karten tuaj SIM ne Modem USB dhe kete te fundit ne Laptop ose PC.

### **Vodafone Albania**

Ofron shërbimin e internetit ne menyre te ngjashme si Eagle Mobile, bazuar ne teknologjine GPRS. Per klientet e tij mundeson aksesin ne internet nepermjet SIM Card dhe Modem Card ne menyre te ngjashme si Eagle Mobile. Duke mos e konsideruar te nevojshme zgjatjen e metejshme , pasi pershkruam ne menyre te detajuar te Eagle Mobile, sjellim ne vemendje qe:

Kapaciteti dhe cmimi i ofruar per paketen 15 MB dhe Modem Card eshte:

15 MB tarifohen me 100 leke (pa tvsh)



Modem Card kushton 7000 leke (me tvsh)

### **Albania Mobile Communication**

AMC ofron shërbimin “Wireless Internet” nëpërmjet teknologjise GPRS. Përshkrimi i menyrës së ofrimit dhe menyra e aktivizimit të internetit është e njëjta si për rastin e Eagle Mobile dhe Vodafone Albania

Specifikat e ofrimit të shërbimit të internetit nga AMC përmbledhen në:

- Lidhje me internetin nëpërmjet celularit ose laptop/Desktop PC.
- Mundësinë e pagesës në bazë të volumit të transferimit të të dhënave dhe jo të kohëzgjatjes së lidhjes.
- Mundësinë e pranimit dhe bërjes së telefonatave edhe kur klienti është i lidhur me Internetin.
- Shërbimi internetit u ofrohet të gjithë abonentëve AMC, me parapagesë dhe me kontratë.

Tarifa për shërbimin 1GB Internet është 3000 lekë në muaj (përfshirë TVSH) e cila përfshin 1 GB falas. Për çdo MB të përdorura mbi këtë paketë çmimi është 50 lekë/MB.

AMC ofron paketa ofertuese të ndryshme të shërbimit në internet dhe në një përmbledhje për ilustrim është si më poshtë:

Abonentët, pasi konsumojnë 100 MB e përfshirë në aktivizim, mund të zgjedhin njërin nga dy paketat e postës elektronike (100 Mb ose 1 GB) ose mund të paguajnë në bazë të konsumit.

- Pagesa në bazë të konsumit është 25 lekë/MB, ndërsa tarifimi fillestar është për 1 kb
- Paketa e parë e postës elektronike: duke dërguar **mymail300** në numrin **15158**. Kushton 300 lekë dhe përmban 100 MB postë elektronike, të vlefshme për një javë.
- Paketa e dytë e postës elektronike: duke dërguar **mymail1500** në numrin **15159**. Kushton 1500 lekë dhe përmban 1 GB postë elektronike, të vlefshme për një muaj.

**Card Modem** apo e njohur si **Karta Wireless Connect** e cila mundeson lidhjen me internetin në Laptop/PC, mundësohet nëpërmjet një pakete e cila kushton 9,900 lekë (me TVSH) dhe blihet në dyqanet AMC.

Çmimi për çdo MB, pas paketës mujore falas prej 2 GB, është 30 lekë (pa TVSH) dhe tarifimi kryhet për çdo 10 KB.

### **Avantazhet e kesaj pakete te ofruar nga AMC jane:**

- Internet pa pasur nevojë për të lidhur kontratë.
- Tarifa shumë të ulëta (30lekë/MB).
- Mundësi për të dërguar ose marrë SMS (14.17 lekë/SMS pa TVSH).

### **Aksesi në broadband bazuar në Fixed Wireless Access**

Aksesi ne broadband nepermjet FWA eshte realizuar nepermjet sherbimeve HotSpot. Ne pyetesoret e plotesuar nga operatoret e tregut e identifikojne kete sherbim dhe ne praktiken e perditshme ekziston ne lokale, hotele, aeroporte, porte dhe zona te ndryshme gjeografike duke krijuar mundesine e aksesit ne broadband qe realizohet nepermjet ketij sherbimi. Sipas te dhenave rezulton se deri ne fund te 2009 jane identifikuar 2800 pajtimtare te ketij sherbimi

Sherbimi HotSpot krijon akses ne broadband duke u bazuar ne teknologjine WLAN, por krahasuar me sherbimin ADSL, ka diference ne cimimin e ofrura per te njejtin kapacitet te kontraktuar. Por edhe pse nga pikepamja funksionale te krijon pershtypjen e zevendesueshmerise se aksesit me ADSL, persa i perket karakteristikave te tjera nuk duhet konsideruar si nje zevendesim i plote.

### **Aksesi ne broadband bazuar ne FWA mbi sherbimin Homebox**

Pervec sherbimit HotSpot i cili mundesohet nepermjet FWA, aksesit ne broadband nepermjet FWA realizohet edhe nepermjet sherbimit Homebox. Nje sherbim i tille realizohet ne rrjetin e komunikimeve elektronike mobile, duke perdorur spektrin e radio-frekuencave. Ky sherbim eshte i bazuar ne teknologjite EDGE, UMTS duke mundesuar akses ne broadband me shpejtsi deri ne 1.8 Mbit/s dhe ne nje shtrirje gjeografike qe suportohet nga teknologjite UMTS dhe EDGE. Ne kete menyre cilesia e aksesit ne internet nepermjet rrjetit mobile, varet nga disa faktore si:


- a) numri i perdoruesve aktive ne te njejtin kohe;
- b) pozicioni gjeografik i perdoruesit ne lidhje me statcionin e sherbimit;
- c) Fuqia e pajisjeve transmetuese te sinjalit etj.

Por aksesit ne broadband nepermjet ketij sherbimi mundeson transferim te dhenash me fuqi dhe cilesi me te ulete se sherbimi ADSL, per te njejtin kapacitet transmetimi, qofte edhe duke konsideruar faktoret e mesipem qe percaktojne cilesine e aksesit ne kete lloj sherbimi. Aktualisht ne Shqiperi nuk ofrohet ky sherbim, por duke qene se Eagle Mobile ofron akses ne internet bazuar ne teknologjine EDGE, e konsideruam me vend te bejme nje pershkrim te ketij sherbimi.

### **Zevendesimi ne anen e kerkeses te aksesit ne tregun e pakices**

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatoret te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.



### Skema nr 1.

Arsyetimi sipas skemes se mesiperme, nenkupton qe lidhjet e mundshme ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, pavaresisht teknologjise se lidhjes derivohehen nga kerkesat ne tregun e pakices.

- c) *Aksesi kabllor, ADSL, FWA (ose tjeter teknologji), numri i kerkesave ne tregun e pakices, kerkesa te cilat mund te plotesojne kriterin e zevendesueshmerise ne "retail", bejne pjese ne te njejtin treg.*
- d) *Te gjitha vetefurnizimet plotesojne kriterin e zevendesueshmerise ne "retail", per rrjedhoje tregon qe keto vetefurnizime pavaresisht teknologjise mbi te cilen mbeshteten perfshihen ne te njejtin treg.*

Sipas arsyetimit te mesiperme konkludojme se:

- 1) *Teknologjite ( X DSL dhe Kabell Modem, FWA) qe mundesojne sherbimin e aksesit ne broadband ne aspektet kryesore kane ngjashmeri dhe jane pjese te te njejtit treg.*
- 2) *Teknologjite qe mundesojne sherbimin e aksesit ne broadband, gezojne parimin e zevendesueshmerise sipas kerkese/ofertes sipas ilustrimit te trajtuar ne skemen nr.1.*

*Arsyetimi i dhene ne skemen nr.1, ne lidhje me mundesine e zevendesimit te kerkesave ne nivel „retail“ te broadband nga ofertues te ndryshem, qe ne fund te fundit sjellin zevendesimin e kerkesave te perdoruesit fundor, tregon se pavaresisht teknologjise qe mundeson akses ne broadband kemi te bejme me pjese te te njejtis treg. Ne nivelin e ketij arsyetimi do te bazohet edhe trajtimi me i detajuar i teknologjive qe mundesojne akses ne broadband duke pozicionuar me tej arsyetimin tone ne lidhje me teknologjite e sipercituara ne tregun e shumices te aksesit ne broadband.*

### **Konkluzion i AKEP per aksesin ne broadband ne tregun e pakices**

Duke konsideruar pershkrimet e mesiperme per teknologjite perkatese qe mundesojne akses ne broadband ne tregun e pakices, bazuar edhe ne parimin e zevendesueshmerise se ketij aksesit sipas teknologjive te pershkuara, mund te themi qe:

Kerkesat baze te identifikuara sipas pyetesoreve te plotesuar nga ofruesit e sherbimit te internetit, jane te origjinuara nga tregu i pakices dhe kryesisht mbeshteten ne teknologjite:

- X DSL
- Rrjete kabllore
- Fiber Optike

### **Aksesi ne broadband sipas kategorive (Familjare dhe Biznes) ne tregun e pakices.**

Per te patur akses ne kete treg, para se gjithash nje pajtimtar kontraktin kete akses kundrejt nje tarife ne te cilen perfshihen (kapaciteti i kontraktuar, teknologjia e zgjedhur, afati kohor i kontraktuar etj).

*a) Si duhet konsideruar nje pajtimtar? A eshte ai nje rishites apo eshte perdorues fundor?*

*b) A do kishte ndryshim tarifa per te patur akses ne kete treg per kete pajtimtar ne te dy rastet e sipercituara?*

*c) A kane shtrirje ISP-te ne te dy tregjet vertikalisht, apo ekzistojne tregje vetem ne rrafshin horizontal?*

*d) A eshte e mundur te identifikohen “pajtimtaret rishites” me pajtimtaret jo rishites? A ka diference ne tarifim per te njejtin tip aksesit per teknologji te ndryshme?*

Referuar situates aktuale te tregut te aksesit ne broadband konkludojme qe:

- Te gjitha teknologjite qe mundesojne aksesin ne tregun e pakices ne broadband, jane pjese e te njejtis treg.
- Te dy kategorite e pajtimtareve (familjare dhe biznes) qe aksesohen ne broadband bejne pjese ne te njejtin treg.

**Aksesi ne narrowband dhe broadband ne tregun e pakices. Karakteristikat funksionale te tyre sipas teknologjive qe mundesohet ky akses.**

Aksesi ne Narrowband dhe Broadband nuk mund te konsiderohen teresisht ne zevendesueshmeri te plote sepse:

- a) *Karakteristikat funksionale jane te ndryshme (kapaciteti ne download dhe upload)*
- b) *Struktura e cmimit qe mundeson sherbimin e aksesit ne dy bandat nuk eshte e njejte. (kemi te bejme me struktura te ndryshme cmimi qe mundesojne kete akses)*

**Ne lidhje me aksesin mund te themi qe korniza e tregut te pakices perfshin:**

- a) *Aksesi qe realizohet ne Narrowband apo Broadband per tregun e pakices, duhet konsideruar si pjese e te njejtit treg te pakices edhe pse jo ne perputhje te plote te karakteristikave funksionale, duke perjashtuar "produktet dhe sherbimet qe mundeson" ky akses.*
- b) *Aksesi i realizuar mbi te gjitha platformat qe shfrytezojne teknologjite XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologjine kabllore, FWA apo teknologji te tjera qe mundesojne aksesin ne broadband, jane pjese te te njejtit treg.*
- c) *Aksesi i realizuar per te dy kategorite (familjar + biznes), ne tregun e pakices, eshte pjese e te njejtit treg.*

## IV. ANALIZE E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND

### IV.1. Perkufizimi i tregut me pakice te linjave me qera

Ne rregullore, tregu me shumice i aksesit ne broadband eshte tregu nr. 15, i cili eshte percaktuar si:

- Tregu me shumice aksesit ne broadband

Perkufizimi i ketij tregu eshte i njejte me perkufizimin e dhene ne rekomandimin e KE te vitit 2003 per tregjet perkates. Ne perputhje me piken 3 te nenit 3 te Rregullores, ne kete seksion analizohet dimensionimi i produkteve/sherbimeve dhe dimensionimi gjeografik i tregut me pakice te linjave me qera, per te percaktuar sherbimet te cilat jane pjese e te njejtin treg perkates.

### I. Dimensionimi i produkteve/sherbimeve te tregut me shumice te aksesit ne broadband

Dimensionimi i produkteve dhe sherbimeve ne tregun me shumice te aksesit ne broadband percaktohet si:

- a) akses ne broadband duke u mbeshtetur mbi nje rrjet publik telefonik fiks nga nje vendodhje fikse.
- b) Akses ne broadband duke shfrytezuar linja kabllore (infrastrukture te ngritur nga ana e ISP-ve)
- c) Akses ne broadband duke shfrytezuar teknologji te tjera te cilat bazohen ne perdorimin e frekuencave

Numri i kerkesave te gjeneruara ne tregun e pakices per aksesin ne broadband pavaresisht teknologjise me te cilen eshte realizuar aksesin, gjejne zgjidhje nga aksesin ne broadband dhe per rrjedhoje ne tregun e shumices perfshihen te gjitha llojet e teknologjive qe e mundesojne kete akses.

#### **Per rrjedhoje:**

*Aksesin i realizuar mbi te gjitha platformat qe shfrytezojne teknologji XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologji kabllore, FWA apo teknologji te tjera qe mundesojne aksesin ne broadband bejne pjese te te njejtin treg te shumices.*

### **Zevendesimi ne anen e kerkeses – ne tregun e shumices te aksesit ne broadband**

Zevendesueshmeria persa i perket anes se kerkeses ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, duhet te mundesojte zevendesimin e sherbimit te bazuar ne X teknologji me te njejtin sherbim te bazuar ne teknologji Y, si nje sherbim te vlefshem ne tregun e shumices te aksesit ne broadband per perdoruesit e ketij sherbimi te cilet duhet te marrin ne konsiderate rritjen e

cmimit te ketij sherbimi per te patur akses ne infrastrukturen sipas teknologjise zevendesuese, duke perdorur sherbimin e aksesit ekuivalent ne kete treg.

Zevendesueshmeria duhet konsideruar ne termat e funksionalitetit dhe te cmimit duke analizuar karakteristikat teknike perkatese.

Zevendesueshmeria ne nivelin e shumices te aksesit ne broadband, transferon kete zevendesim ne tregun e pakices nepermjet dy menyrave:

- d) Te vetefurnizimit;
- e) Te dhenies se aksesit per te tretet ne infrastrukturen egzistuese;

Me fjale te tjera ne se nje operator deshiron te furnizojte me akses ne broadband perdoruesin fundor ne nivelin e pakices, jo domosdoshmerisht duhet te kete infrastrukture ne pronesi, pasi mund te perdore sherbimin e aksesit ne nivelin e shumices.

Ndaj ne dakortesi me Rekomandimin e Komisionit European ne tregjet e mundshme per rregullime ex-ante, tregu i shumices te aksesit ne broadband, perfshin edhe bitstream akses nga nje vendodhje fikse.


### Sherbimi i Bitstream Internet Akses sipas ERG (Qendrim i perbashket ERG)

Sherbimi “Bitstream” perbehet nga keto elemente:

- Lidhje e ISP me DSLAM te operatorit incumbent;
- Lidhje e ISP me pikat fundore te rrjetit;
- Lidhje e DSLAM me rrjetin e operatorit incumbent;
- Lidhje bazuar ne aksesin ne rrjet mbi fille bakri nga DSLAM tek perdoruesi fundor.

Kjo eshte rruga qe nje ISP mund te bleje kete sherbim tek operatori incumbent si lidhjen dhe kapacitetin ne bandwidth per te furnizuar perdoruesin fundor duke perdorur pajisjen DSLAM.

Ne fig me poshte ilustrrohet nje skeme e mundshme e Bitstream Access



Source: ERG (03) 33rev2, ERG Common Position on wholesale bitstream access

## **Aksesi ne broadband ne tregun e shumices ne Shqiperi**

Sherbimi i aksesit eshte nje sherbim i trajtuar edhe ne analizat e telefonise fikse dhe te levizshme, si dhe eshte konsideruar si nje nder detyrimet rregullatore te vendosura ne masat rregulluese per operatoret me FNT sipas gjetjeve te analizave perkatese te kryera. Ndaj ne zbatim te detyrimeve te vendosura per keta operatore, nder te tjera eshte edhe hartimi dhe publikimi i RIO-ve, ku nje vend te rendesishem ze aksesi ne infrastrukturen e ngritur te ketyre operatoreve. Por duke qene se eshte analiza e pare qe mbahet per aksesin ne broadband ne tregun e shumices, eshte e natyrshme qe per sherbimet dhe teknologjite e pershkruara ne tregun e pakices, te konsiderohen ne se ka prezence te tyre ne tregun e shumices, per rrjedhoje ne se mundesohet aksesi ne kete treg.

### **a) Sherbimi transportit te ADSL**

Sherbimi i mbartjes (transportit) te ADSL krijon mundesi qe operatori te furnizojë ne broadband perdoruesit fundor me sherbimin ADSL, te cilet jane ne te njejten kohe te aksesuar ne sherbimin ADSL ne nivel shumice.

Sherbimi iransportit te ADSL perfshin:

- a) Vendosjen e aksesit te operatorit ne platformen e operatorit incumbent ne zonen qe operatori incumbent ka nyje per akses ne broadband;
- b) Tranferimin e te dhenave te perdoruesit fundor te lidhur ne DSLAM, i cili eshte lidhur ne rrjetin e operatorit incumbent qe ka platformen ne te cilen eshte aksesuar ne broadband operatori ofertues dhe anasjelltas.

Ne nje pershkrim me te plote duhet thene qe operatoret e rinj duhet te sigurojne akses nga rrjeti i tyre ne rrjetin e operatorit incumbent me qellim qe te mundesojne sherbimin e aksesit per perdoruesit fundor ne tregun e pakices. Ky eshte nje sherbim i ngjashem me sherbimin a aksesit per rrjetet e telefonise fikse apo te levizshme, te cilet lejojne transportimin (tranferimin) e trafikut te tyre kundrejt detyrimeve perkatese qe kane per aksesin ndaj operatorit ofertues ne nivel shumice.

### **b) Sherbimi i aksesit te ADSL ne tregun e shumices perfshin:**

- a) Akses ne broadband te perdoruesit fundor ne rruge virtuale ne piken e aksesit ne DSLAM ne rrjetin e operatorit incumbent.
- b) Menaxhimi i DSLAM dhe konfigurimi per perdoruesin fundor, qe do te thote qe sherbimet qe mund te ofroje operatori ofertues i aksesuar ne broadband per perdoruesin fundor suportohet nga infrastruktura e operatorit incumbent, nga pika e aksesit ne DSLAM te perdoruesit fundor deri ne aksesin e mundshem qe ka operatori ofertues ne tregun e shumices ne broadband.



Me fjale te tjera sherbimi i aksesit te ADSL eshte i lidhur me sherbimin e transportit te ADSL dhe mund te aplikohet per rastin kur perdoruesit fundor jane pajtimtare te rrjetit te operatorit incumbent.

Ne kete menyre per perdoruesin fundor i cili perfiton nje grup sherbimesh eshte e mundur te behet faturimi edhe ne nje fature te vetme duke detajuar llojet e sherbimeve per aksesin, trafikun e transportuar etj, dhe duke lehtesuar ne kete menyre kryerjen e sherbimit.

Karakteristikat teknike dhe funksionale te ketij sherbimi per perdoruesin fundor dhe kryesisht shpejtesia e ADSL, ne maksimumin e mundshem duhet te jene sipas percaktimeve te lejuara nga operatori incumbent.

Zevendesueshmeria ne anen e kerkeses ne tregun e pakices mund te percaktoje edhe zvendesueshmerine ne nivel shumice te ketij sherbimi per aksesin ne broadband, qe eshte sherbimi i bitstream akses ne tregun e shumices bazuar ne IP reale e cila suportohet nga teknologjia ADSL dhe eshte e kushtezuar nga veprimet qe ndermerr operatori incumbent qe ofron akses ne broadband ne nivel shumice per operatorin ofertues te perdoruesit fundor.

Duhet vleresuar si e rendesishme ne se eshte i mundur zevendesimi i sherbimit te bitstream akses ne piken e aksesit ne nivel IP i cili bazohet mbi teknologjine ADSL, me te njejtin sherbim te suportuar nga teknologji te tjera por qe kerkon nje arkitekture tjeter te rrjetit.

Ne skemen e bitstream akses sipas ERG jane trajtuar kater pika te mundshme aksesit qe mundsohet kalimi nga njera tek tjetra, por ajo qe eshte e rendesishme eshte fakti qe pika te ndryshme te aksesit i japin mundesi te ndryshme operatorit ofertues per perdoruesin fundor duke u kushtezuar nga arkitektura e rrjetit te operatorit incumbent. Ndaj per kete arsye opsioni me i diskutueshem eshte ne se bitstream akses i ofruar ne DSLAM me bitstream akses i ofruar ne ATM jane te zevendesueshme dhe te suportuara ne teknologjine ADSL mbi nje cift telash bakri.

Qendrimet e mbajtura deri tani kryesisht, perjashtojne mundesine e zevendesueshmerise se bitstream akses ne nivel IP me bitstream akses ne nivel ATM dhe kjo eshte nje dakortesi e arritur ne ERG, por duke mos perjashtuar faktin qe dimensionin e sherbimeve te ofruara ne tregun e shumices te aksesit ne broadband te perfshije edhe bitstream akses ne nivel IP.

### **Sherbimi “Bitstream access” ne DSLAM**

Sherbimi bitstream akses ne DSLAM mundeson operatoret qe te furnizojne ne tregun e pakices te njejtat sherbime qe furnizojne te bazuar ne bitstream akses ne nivel IP. Mundesia e zevendesueshmerise te bitstream akses ne nivel IP me bitstream akses ne DSLAM eshte me e madhe se ne pikat e tjera te aksesit te bazuara ne teknologjine ADSL, pasi arkitektura e DSLAM nga e cila mund te ofrosh mbi 300 fille dyshe bakri (por qe gjejne mundesi te zevendesohen edhe me pajisje EMSAN qe mundsojne 720 dalje fille dyshe bakri), qe do te thote si mundesi aksesit per perdoruesin fundor, te krijon idene qe ne rastin e nje rritje te mundshme te cimit te bitstream akses ne nivel IP, kerkesat e mundshme nga tregu i pakices mund te gjejne zgjidhje te bazuar mbi te njejten teknologji ADSL, por tashme bitstream akses ne nivel DSLAM. Per

rrjedhoje eshte arritur qendrimi edhe ne ERG se ne kete rast mund te kemi zevendesueshmeri ne anen e kerkeses qe origjinohet nga tregu i pakices.

**Sherbimi bitstream akses bazuar ne zgjidhje teknike te avancuara ne akses ne rrjet si sherbim zevendesues per sherbimin bitstream akses te bazuar ne teknologjine ADSL mbi file dyshe bakri.**

Mundesite per te patur akses ne rrjetin e operatorit incumbent nuk jane te limitura nga fakti qe egzitojne teknologji te ndryshme per te realizuar kete. Kjo vihet re tek ndertimi i rrjeteve me fiber optike, kablllo koaksial qe mundesojne nje zevendesim te plote te filleve dyshe te telave te bakrit duke mundesuar nje furnizim me sherbime edhe me kualitet me te larte per perdoruesin fundor, d.m.th akses akses ne shpejtesi me te madhe dhe nje rrjet me kosto me te reduktuara. Zgjidhje te reja teknike te bazuara mbi teknologjine fiber optike mundesojne arkitektura te rrjetit qe njihen ne terminologjine e perdorur si:

• *Fibre to the Cabinet (FttCab)*; • *Fibre to the Building (FttB)*; • *Fibre to the Home (FttH)*

Ndertimi i arkitekturave te rrjeteve te reja te bazuara ne teknologji me te avancuara (zgjidhje te reja teknike) lejon te arsyetohet mbi mundesine e zevendesueshmerise midis sherbimit bitstream akses te bazuar ne teknologjine ADSL (sipas niveleve te pershkruara me siper) me sherbimin bitstream akses te mundesuar nga teknologji me te avancuara dhe me e mundshme eshte zevendesueshmeria bazuar ne teknologjine fiber optike.

**Sherbimi unbundled akses ne local loop si sherbim zevendesues per sherbim bitstream akses**

Sherbimi bitstream akses i ofruar ne nivel shumice qe mundeson akses per operator ofertues te aksesit ne broadband te perdoruesve fundor ne tregun e pakices, konsiderohet si i zvendueshem nga sherbimi i aksesit ne local loop (unbundled akses), i cili ne vetevete eshte i kategorizuar si full dhe shared unbundled akses ne local loop.

Sherbimi i unbundled akses ne local loop ne dy versionet e saja (full dhe shared) perben ndryshim per faktin qe ne version “full” mundesohet per operatorin qe te perdore te dhenat zanore dhe te dhenat per internet ( nje perdorim te plote te aksesit) d.m.th banden zanore e cila eshte ne perdorim nga operatori incumbent per pajtimtaret e tij dhe (copper loop) per transmetim te dhenash, ndersa ne version “shared” lejohet te perdore vetem (copper loop) per transmetim te dhenash dhe jo banden zanore te operatorit incumbent.

Ne listen e tregjeve te parashikuar ne Rekomandimin e BE-se te 2003 dhe 2007, jane parashikuara si dy tregje te ndara per rregullime ex-ante, sherbimi i aksesit ne broadband ne tregun e shumices dhe sherbimi i aksesit ne unbundled ne tregun e shumices. Nje operator qe deshiron te furnizoje ne tregun e pakices akses ne broadband i cili ka akses ne broadband ne tregun e shumices i mundeson atij sherbime ekuivalente per perdoruesin ne tregun e pakices edhe edhe duke qene i aksesuar ne tregun e shumices ne unbundled local loop. Arsyetimi i mesipem eshte ne pikepamje te zevendesueshmerise nga ana funksionale, por edhe ne termat e cmimit nuk perben ndonje ndryshim te konsiderueshem ne koston e operatorit qe deshiron te ofroje ne tregun e pakices, kalimi ne unbundled local loop.

Sherbimi unbundled akses ne local loop ne nivel shumice i mundeson operatorit te aksesuar te ofroje ne tregun e pakices duke derguar me pare kete akses ne DSLAM, dhe me pas duke furnizuar perdoruesin fundor me sherbimet e plota. Karakteristikat teknike te ketij sherbimi si shpejtesia etj, jane te lejuara nga operatori incumbent kundrejt percaktimeve teknike qe parashikohen me pare.

Elemente te tjere qe ndikojne ne kete sherbim jane: zona gjeografike ku do te ofrohet sherbimi per perdoruesit fundor ne te cilen do te instalohet edhe DSLAM per te lejuar me pas daljet e mundshme qe te aksesohet perdoruesi fundor dhe ka ngjashmeri me sherbimin bitstream akses ne te cilen perseri operatori incumbent percakton planin e zhvillimit te rrjetit te operatorit qe aksesohet ne nivel shumice.

Operatori ofertues ne tregun e pakices i cili eshte aksesuar ne nivel shumice ne rrjetin e operatorit incumbent eshte i kushtezuar ne karakteristikat teknike te sherbimit qe i mundeson perdoruesit fundor dhe nder te tjera varet edhe nga pozicioni gjeografik qe ka perdoruesi fundor me piken e aksesit ne DSLAM ( ne vendin ku DSLAM eshte instaluar).

Me fjale te tjera ashtu si ne ofrimin e sherbimit bitstream akses edhe ne ofrimin e sherbimit unbundled local loop, operatori i aksesuar ne nivel shumice nuk ka kontroll te plote mbi aksesin e ofruar per perdoruesin fundor. Per rrjedhoje sherbimi i aksesit ne unbundled ne local loop ne lidhje me krahasimin e plote te cmimit dhe funksionalitetit, nuk mund te konsiderohet plotesisht i zevendesueshem, ose me sakte nuk eshte pjese e te njejtit treg. Ndaj edhe ne rekomanimet perkatese eshte parashikuar te analizohen si tregje te vecanta.

### **Zevendesueshmeria e sherbimit bitstream akses bazuar ne ndertimin e infrastrukturave te reja paralele te operatorit incumbent.**

Ne se ne nje situate hipotetike do te konsideronim qe nje operator nderton nje infrastrukture per ofrimin e sherbimit bitstream akses, atehere do te duhej te analizoheshin keta faktore:

- a) *Koha e gjate per ndertimin e kesaj infrastrukture, e cila mund te jete zevendesuese e infrastruktures se operatorit incumbent;*
- b) *Kostot e ndertimit;*

Te dy keta faktore te konsideruar te nevojshem do te percaktonin edhe strukturen e cmimit te ofrimit te ketij sherbimi. Por qe te realizohej nje infrastrukture paralele do te duhej qe te justifikoheshin nga:

- *Densiteti i perdoruesve te mundshem qe do te aksesoheshin ne kete infrastrukture;*
- *Penetrimi i mundshem te justifikojte ndertimin e nje infrastrukture te tille duke e konsideruar si nje infrastrukture zevendesuese e operatorit incumbent ne ofrimin e sherbimit bitstream akses.*

Barrierat e mundshme ne ndertimin e infrastrukturave paralele (zevendesuese te operatorit incumbent), nuk favorizojne mundesine e sherbimit zevendesues per sherbimin e bitstream akses.

### **Vetefurnizimi ne sherbimin e aksesit ne broadband si nje sherbim zevendesues per bitstream akses.**

Ne perskrimin e bere te sherbimit te aksesit ne nivel pakice te bazuar ne teknologji te ndryshme u arrit ne konkluzionin qe mund te konsiderohen si te zevendesueshme nga ana funksionale ne lidhje me aksesin e ofruar, pavaresisht llojit te teknologjise. Nder teknologjite qe arsyetohen me te mundshme ne anen e zevendesuesmerise te kerkesave ne nivel pakice duke konsideruar termat e cmimit dhe funksionit ishin : teknologjia x DSL, rrjete kabllore, fiber optike. Cmimi per aksesin e ofruar do te percaktohej edhe nga faktore te tille si: infrastruktura e operatorit qe ofron sherbimin e aksesit, apo te kontraktuar me qera, etj.

Vetefurnizimi eshte nje nder sherbimet qe percakton edhe hirearkine e tregjeve (vertikale), duke e konsideruar ne menyre hipotetike se rritja e cmimit ne ofrimin e sherbimit bitstream akses nga operatori incumbent per operatorin qe aksesohet ne nivel shumice, do te transferonte ne menyre llogjike rritje te cmimeve ne tregun e pakices per perdoruesit fundor. Ne kete rast perdoruesi fundor duke u perballur me rritje te cmimit per aksesin e kontraktuar te bazuar ne sherbimin bitstream akses te ofruar nga operatori ofertues qe ka akses ne nivel shumice ne rrjetin e operatorit incumbent, perdoruesi fundor do te orientohej drejt sherbimeve qe ofron operatori incumbent si nje mundesi per te perfituar cmim me te mire.

Operatori i aksesuar ne infrastrukturen e operatorit incumbent per sherbimin e bitstream akses, ne rast te nje rritje te mundshme te cmimit nuk mund te jete i paperfillshem per tregun e pakices ne te cilen eshte infrastruktura egzistuese e operatorit incumbent, ndaj ne tendence per te mbajtur perdoruesin fundor duke mos i ndryshuar cmimin e sherbimit te aksesit te ofruar, mundesia qe te jete pre e presionit te operatorit incumbent eshte e madhe, per rrjedhoje jemi ne kushtet e zbehjes se presionit konkurses, qe do thote se mundesia qe perdoruesi fundor te zevendesojte sherbimin e bitstream akses nga ky operator me sherbimet e ofruara nga operatori incumbent eshte madhe.

Keshtu qe ne zona gjeografike ku operoret ofrojne sherbimin e aksesit ne broadband per qellime vetefurnizimi, presioni konkurses ne nivel pakice eshte i rendesishem, dhe per rrjedhoje ne mungese te detyrimeve qe mund te ishin ndaj operatorit incumbent, per t'u mos lejuar te ofronte keto sherbime poshte nje niveli te caktuar cmimi, por gjithesei kjo nuk do te perbente zgjidhje te situates.

### **Zevendesimi ne anen e ofertes**

Parimi i monopolistit hipotetik sjell ne vemenedje se, ne rastin e rritjes se cmimit nga nje operator qe ofron sherbimin e aksesit ne broadband bazuar ne bitstream akses ne tregun e shumices, per sherbime ekuivalente ne kete treg, pa kosto shtese te rendesishme do te mundesohej zevendesimi i ofertes nga perfituesi.

Por ne rastin e operatorit incumbent qe tregu i mundshem per te cilin nje operator i aksesuar ne bitstream akses ne nivel shumice dhe qe tenton te marre treg nga pajtimtaret e infrastruktures se operatorit incumbent do te ishte e paperballueshme mundesia e presionit, ne mungese te nje infrastrukture alternative te vete operatorit.

Sherbimet ekuivalente te bitstream akses te bazuara si akses ne rrjete kabllore per zonat gjeografike qe egzistojne rrjete te tilla, shpesh here ndeshet me kufizime ne shtrirjen gjeografike dhe nuk plotesojne kriteret e zevendesueshmerise se plote per sherbimin bitstream akses te bazuar ne teknologjine DSL.

Per pasoje ne rastin e rritjes hipotetike te cmimit ne sherbime te pershtatshme per operatoret qe bazohen ne teknologjine DSL dhe qe mundesojne aksesin ne broadband ne tregun e shumices, nuk jane te motivuar qe te zevendesojne me sherbime te mundshme te krahasueshme per arsye te kostove qe shoqerojne kete nderrim.

*Per rrjedhoje ne nje konkluzion me te permbledhur mund te thuhet qe aktualisht per vete fazen e zhvillimit te infrastrukturave paralele qe konkurojne operatorin incumbent, sherbimet alternative te bitstream akses nuk duhen konsideruar si zevendesues te tij, por kjo nuk e perjashton mundesine ne rastin e kundert kur kemi infrastrukture te zhvilluar per teknologjite mbi te cilat mund te mbeshitet bitstream akses .*

### **Konkluzion mbi dimensionin e sherbimeve ne tregun e pershkruar**

*Ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, sipas pershkrimeve te bera me siper mund te konkludohet se:*

*Sherbimi bitstream akses perfshin pikat qe lejojne kalimin e trafikut midis operatorit furnizues me sherbime dhe operatorit qe perdor keto sherbime, pavaresisht teknologjise mbi te cilen mundesohet akses duke konsideruar si pika aksesit pikat e meposhtme:*

- *Pike e aksesit ne nivel IP,*
- *Pike e aksesit ne nivel ethernet,*
- *Pike e aksesit ne DSLAM*
- *Sherbimet e ofruara nga vetefurnizimi, pavaresisht teknologjise se perdorur.*

### **II. Dimensioi gjeografik i tregut te shumices per aksesin ne broadband**

Duke konsideruar si dimension gjeografik zonen e cila mbulohet me sherbim, nuk duhet lene jashte vemendjes edhe hapësira e mundshme potenciale per te ofruar kete sherbim ne te gjitha zonat qe mundesohet nje sherbim i tille, si pasoje e shtrirjes se rrjeteve dhe mbulimit gjeografik.

Mungesa e barrierave ligjore per te shtrire dimensionet e sherbimit ne rang kombetar, prezenca ne tregje te tilla e operatoreve incumbent me nje infrastrukture me shtrirje kombetare (kryesisht ne zonat urbane), si dhe mundesia per te mbuluar zona te cilat kane mungese rrjeti , lejojne te arsyetojme qe teknologji te tjera mund te mbulojne zona te tilla. Per rrjedhoje jemi ne kushtet e nje tregu me dimension kombetar.

Ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, Udhezimimi i KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojne midis te tjerave se dimensionin gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Albtelecom , Abcom, ASC, Abissnet si dhe ndo nje nga ofruesit e ofrojne sherbimet e tyre ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ne kete menyre mund te konkludojme se:

- *Dimensioni gjeografik i sherbimit te aksesit ne broadband ne tregun e shumices, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.*

Per sa me me siper, percaktimi i tregut me shumice te aksesit ne broadband perfshin:

- **Tregu me shumice aksesit ne broadband;**
- **Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar;**

## IV.2 Analiza per Fuqi te Ndjeshme ne Tregun me shumice te Broadband

Per te analizuar egzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33, ne piken 2 percaktohen nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate, dhe midis te tjerave citon:

2. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

- a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si dhe ndryshimet në kohë në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;
- b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritsëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;
- c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- ç) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;
- d) në fazën e tregut përkatës;
- dh) në përparësitë teknologjike;
- e) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;
- ë) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;
- f) në shkallën e integritit vertikal;
- g) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;
- gj) në aksesin në burimet financiare;
- h) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;
- i) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifat, paketat e shërbimeve dhe të produkteve ose vendosjen e pengesave.

Lista e kriterëve nuk është liste kumulative apo përjashtuese e kriterëve/karakteristikave të tjera për dominancë apo FNT.

### I. Pjesët e tregut


AKEP, me qëllim kryerjen e një analize tregu për aksesin në broadband në nivel shumë të lartë sa me të plotë, ka kërkuar nga operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit të regjistruar si sipërmarrës, informacion në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi. Për këtë është përgatitur një pyetsor i cili u publikua në faqen zyrtare të AKEP që në 16.06.2009. Në këtë pyetsor përfshiheshin aspektet kryesore të shërbimit në broadband si zona gjeografike ku shtrihet ky shërbim, kapaciteti që ofrohet, mënyra e aksesit në tregun ndërkombëtar dhe në atë kombëtar, numri i pajtimtareve sipas teknologjive që ofrohen, të ardhurat që krijonin nga ky shërbim si dhe elemente të tjera të detajuara. Por vetëm një pjesë e operatorëve u përgjigjen, dhe përgjigjet e tyre ishin në mënyrë të pjesshme për këtë pyetsor, ndaj AKEP u dergoi serish shkresë zyrtare me Nr.Prot.5029 dt.31.12.2009, gjithësej 90 sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike që kanë njoftuar për ofrimin e këtij shërbimi, duke u rikujtuar faktin që të plotësonin pyetsorin që ishte publikuar në faqen zyrtare të AKEP. Sipas evidencës së përpunuar nga të dhënat e derguara, rezultoi se kanë plotësuar këtë pyetsor gjithësej 36 sipërmarrës, edhe pse zyrtarisht janë përgjigjur 48 të tillë. Një pjesë e mirë e tyre informojnë se megjithëse kanë njoftuar për

ofrimin e ketij sherbimi ne AKEP, akoma ky sherbim nuk eshte bere aktiv nga ana e tyre. Ky disporpocion ndermjet numrit te operatoreve qe kane njoftuar per ofrimin e ketij sherbimi dhe te atyre qe realisht jane aktiv ne treg, mund te jete edhe pasoje e liberalizimit te tregut (si pasoje e nje detyrimi thjesht per te njoftuar ne ofrimin e nje sherbimi) dhe tendences se operatoreve per te perfshire pjesen derrmuese te sherbimeve qe egzistojne ne tregun e komunikimeve elektronike ne njoftimet perkatese, por pa arritur qe sejcilin nga sherbimet e ofruara te behet aktiv. Ndaj sipas ketyre te dhenave te evidentuara rezulton se:

Evdientimi numrit te pajtimtareve ne total, numri i pajtimtareve sipas teknologjive, numri i pajtimtareve sipas kategorizimit ne familjare dhe biznes, specifikimin e operatorit ku sigurojne akses ne broadband, kapaciteti i bandwidthi-t te aksesuar, zona gjeografike ku ofrojne sherbimin etj.


Ne menyre analoge eshte bere evidentimi per ofrimin e sherbimit te aksesit ne broadband edhe per operatoret mobile per te cilet eshte evidentuar numri i pajtimtareve ne total (sipas menyres se aksesit ne SIM Card dhe Card Modem), si dhe te kategorizuar ne familjare dhe biznes. Por per vete specifiken qe ka ofrimi i sherbimit te aksesit ne broadband nga operatoret celulare evidentimi i ketyre te dhenave eshte bere i vecante nga te dhenat qe jane evidentuar nga operatoret qe njihen ne treg si ISP (Internet Service Provider).

Ne evidencen permbledhese behet e qarte pesha e sherbimit te aksesit ne broadband sipas teknologjive qe e mundesojne kete akses ndaj per te krijuar nje panorame te pergjithshme te numrit te lidhjeve sipas teknologjive ne total ne tregun e broadband paraqitet ne menyre grafike si me poshte:



**Fig.5 Totali i linjave broadband (Albtelecom dhe te tjeret)**






**Fig.6 % e aksesit ne broadband sipas teknologjive**


Ne kete paraqitje grafike eshte marre ne konsiderate numri i lidhjeve ne total ne broadband, pa specifikuar numrin e lidhjeve ne tregun e shumices dhe ate te pakices.

Sherbimi i internetit me bande te gjere po e zevendeson me ritme te shpejta ofrimin e ketij sherbimi ne bande te ngushte dhe kjo duket qarte ne ndryshimin e ndodhur brenda harkut kohor prej nje viti dhe konkretisht:



**Fig.7 Aksesi ne narrowband dhe broadband (sipas nr te lidhjeve)**

Nga 36 operatore qe kane depozituar te plotesuar pyetesorin rezulton se 20 prej tyre jane te aksesuar tek Albtelekom, 6 prej tyre tek Abissnet, 4 prej tyre tek Abcom, 4 prej tyre tek Primo, etj. dhe me pas e rishesin kete sherbim tek perdoruesi fundor. Nje pjese e operatoreve kane deklaruar sipas pyetsoreve te plotesuar se kane edhe akses ne tregun nderkombetar, por njekohesisht jane te aksesuar edhe tek Albtelekom, dhe se kapacitetin ne bandwidth qe e kane te aksesuar e realizojne nga nje akses i dyfishte sipas pershkrimet te mesiperm. Duke vleresuar nga menyra e aksesit te deklaruar nga operatoret rezulton se tregu i shumices te aksesit ne broadband ekziston dhe se teknologjite qe e mundesojne ate bazohen kryesisht ne lidhjet e dedikuara duke u aksesuar ne tregun e shumices dhe me pas duke e derguar ate deri ne ndertesen e sipermarresit dhe me pas duke perdorur teknologji dhe pajisje qe mundesojne zgjidhje teknike bejne rishitjen e ketij sherbimi ne tregun e pakices.



**Fig.8 Pesha e operatoreve ne % sipas nr te lidhjeve per sherbimin ADSL**

5 operoret e paraqitur ne menyre grafike si: Albtelecom, Abissnet, Abcom, ASC dhe Primo, te marre se bashku ofrojne sherbimin e aksesit ne broadband te bazuar ne teknologjine ADSL rreth 98 % te ketij sherbimi ne totalin e lidhjeve ADSL per te gjithë tregun e broadband.

Ndaj 2% te lidhjeve ADSL te ofruara nga te gjithë operoret e tjere, eshte konsideruar e panevojshme te perfshihen ne paraqitjen grafike te mesiperme.

Ndersa numri i lidhjeve ADSL ne totalin e lidhjeve ne broadaband ze rreth 94% te ketyre lidhjeve dhe per rrjedhoje sherbimi i aksesit ne broadband ze 94% te ketij aksesit qe mundesohet nga teknologjia ADSL. Diferenca prej 6 % e aksesit ne broadband e zene teknologjite e tjera si lidhje te dedikura, mikrovalore (HotSpot) etj.

Keto matje te tregut jane bazuar mbi numrin total te lidhjeve te deklaruar nga ofruesit e ketij sherbimi ne totalin e tyre, pa specifikuar tregun e shumices apo pakices, por ne deklarimet e bera ne pyetesoret e plotesuar rezulton se aksesit ne tregun e shumices nga pjesa dermuese e operatoreve mbi 55% e tyre jane te aksesuar tek Albtelecom, ndersa pjesa tjeter e operatoreve e sigurojne kete akses jashte Shqiperise, ose sigurojne akses nga dy drejtime te ndryshme, duke u bazuar ne teknologji tokesore dhe satelitore. Operatori dyte qe ofron akses ne tregun e shumices ne broadband rezulton te jete Abissnet dhe ze rreth 16 % sipas deklarimeve te bera ne pyetesoret e plotesuar. Per rrjedhoje peshen kryesore ne tregun e shumices te aksesit ne broadband e ze Albtelekom.

Kjo % nuk duhet konsideruar si pjese tregu, sepse eshte bere nje vleresim per numrin e operatoreve qe sigurojne akses tek Albtelecom dhe tek disa opearore te tjere me peshe, por pa specifikuar peshat perkatese te sejcilit per nga numri i lidhjeve. Gjithesesi ne totalin e lidhjeve te deklaruar pesha e Albtelecom eshte e konsiderueshme ne raport me operoret e tjere, por kjo peshe eshte e bazuar kryesisht ne “vetefurnzimin” qe ky operator mundeson per perdoruesit fundor. Ndaj tregu i shumices per aksesin ne broadband duhet vleresuar nga numri I akseseve te realizuara nga ofrues sherbimi te internetit ne nivelin e pakices si dhe nga pesha qe ze sherbimi i vetefurnzimit per Albtelecom.

Per te vleresuar FNT te nje opertori do te bazohemi ne kriteret e listuara me siper te cilat jane te bazuar ne Nenin 33 te Ligjit Nr.9918 dt.19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne RSH" si dhe ne dakortesi me Udhezuesin e Komisionit European sipas kerkesave te aplikuara ne kete treg pjese perberese e tregut te komunikimeve elektronike.

Por ndarjet e tregut pavaresisht rendesise qe kane ne vlersimin e FNT, te vetme nuk percaktojne ne se ka apo FN ne kete treg.

Sipas te dhenave te mesiperme, cilado qofte menyra e vlersimit te tyre, Albtelecom zoteron pjese tergu ne nivele mbi 50% te aksesit ne broadband.Ne Udhezimin e BE-se, shprehet qarte se pjesa e tregut me e madhe se 50 per qind eshte nje tregues i padiskutueshem i fuqise se ndjeshme ne treg dhe, vetem ne raste te rralla mund te ndodhe qe nje operator me pjese tregu te tille te mos kete fuqi te ndjeshme ne treg<sup>3</sup>.

Gjithashtu nje percaktim i rendesishem i nenit 33 per FNT, te Ligjit 9918, eshte pika 5:

*5. Kur një sipërmarrës ka fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ai vlerësohet se mund të ketë fuqi të ndjeshme në treg edhe në një treg përkatës tjetër, të lidhur horizontalisht, vertikalisht ose gjeografikisht me tregun e analizuar, nëse lidhjet ndërmjet dy tregjeve janë të tilla që mundësojnë shtrirjen e fuqisë së ndjeshme nga tregu i parë në tjetrin, duke fuqizuar kështu fuqinë e sipërmarrësit në treg.*

Operatori Albtelekom ka prezence te trashегuar ne rrjetin lokal dhe backobone (si dhe vazhdon investimet ne keto rrjete).

Albtelecom eshte aktualisht operator me FNT ne tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe eshte eshte shpallur me FNT edhe ne analizen e perfunduar ne 2009 te telefonise fikse, "Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse:

Sipas te dhenave te evidentuara ne (dokumentin e Analizes se cituar), Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 80% te pajtimtareve (aksesit), dhe mbi 90% per te ardhurat. Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rendesishem per te shtrire FNT ne tregun me pakice dhe me shumice te aksesit ne broadaband, si nje treg qe mbeshtetet nder te tjera ne kete rrjet.

Operatori Albtelekom eshte gjetur me FN edhe ne tregun e linjave me qera ( setin minimum te linjave me qera ne tregun me pakice si dhe ne tregun e shumices per trunk dhe segmentet

---

<sup>3</sup> According to established case-law, very large market shares — in excess of 50 % — are in themselves, save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position (78). An undertaking with a large market share may be presumed to have SMP, that is, to be in a dominant position, if its market share has remained stable over time.

terminuese). Ky konkluzion eshte evidentuar ne versionin perfundimar te kesaj analize ne muajin shkurt 2010.

Per te gjitha keto arsye te cituara me siper, mund te arrihet ne konkluzionin se Albtelecom eshte operator me fuqi te ndjeshme ne tregun e shumices te aksesit ne broadband.

## **II.Pengesat per hyrje dhe konkurrenca e mundshme ne tregun e aksesit ne broadband**

Pjesa e madhe e tregut e nje operatori mund te mos jete tregues i fuqise se ndjeshme ne treg, ne rast se nuk plotesohen nje sere kushtesh te tjera. Nje nder keto kushte eshte edhe egzistenca e barrierave ne treg. Nese nje operator ka pjese te madhe ne treg, por nderkohe tregu eshte i hapur ndaj operatoreve te rinj, te cilet mund te hyjne dhe dalin nga tregu pa kufizime ligjore dhe kosto ekonomike, atehere aftesia e nje operatori me pjese te madhe tregu per te ndikuar ne kete treg eshte e kufizuar. Por operatoret incumbent sipas te gjitha praktikave nderkombetare duke qene se kane si trashegimi infrastruktura dhe rrjete te ngritura ne kohe, konsiderohen si operatore ne avantazh te ndjeshem me te gjitha hyrjet e reja per te gjitha sherbimet qe suportohen ne keto rrjete. Per rrjedhoje edhe aksesit ne broadband gezon kete avantazh per operatorin incumbent Albtelecom.

Bazuar ne te gjitha praktikat europiane qe kane analizuar tregun e broadband ne vijim do te paraqiten ilustrime perkatese qe tregojne peshen e operatoreve incumbent ne kete treg ne raport me hyrjet e reja qe bazohen ne teknologjite qe suportohen nga rrjetet e tyre. Ne kete ilustrim do te pasqyrohet edhe ecuria ne vite e tyre dhe raporti perkatese ndermjet operatoreve incumbent dhe hyrjeve te reja ne kete treg.

### **Pengesa ligjore**

Ndryshimi kryesor ne lidhje me pengesat per hyrjen ne treg, eshte liberalizmi i tregut dhe lehtesimi i procedurave per sipermarresit ne sektorin e komunikimeve elektronike, qe solli hyrja ne fuqi me 26.06.2008 e Ligjit Nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” dhe kuadrit rregullator te tij, vecanerisht sistemi i Autorizimeve te Pergjithshme. Hyrja ne fuqi e ketij Ligji ka hequr pengesat ligjore per ofrimin e sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike ne shkalle kombetare qe ekzistonin ne Ligjin e meparshem Nr. 8618.

Zevendesimi i sistemit te komplikuar te licensimit me licensa te klasave te ndryshme dhe per zona operimi te percaktuara me sistemin e autorizimit te pergjithshem perben nje eliminim apo reduktim te ndjeshem te pengesave ligjore ne ofrimin e sherbimit te internetit.

Megjithte keto ndryshime ligjore, ne ofrimin e aksesit ne broadband egzistojne pengesa strukturore. AKEP gjykon se konkurrenca e mundshme nga operatoret aktuale dhe te rinj per nje peridhe afatmesme nuk do te jete e mjaftueshme per te kufizuar apo eliminuar aftesine ndikuese

ne treg te Albtelecom, per arsye se Albtelecom zoteron disa avantazhe ndaj operatoreve aktuale dhe te mundshem te cilat do te vazhdoje t'i kete edhe ne nje periudhe afatmesme. Nder keto avantazhe te Albtelecom, apo pengesa strukturore te aksesit ne broadband, mund te permendim avantazhet qe vijne si operator rrjeti kombetar te telefonise fikse (rrjet lokal dhe backbone)<sup>4</sup>:

### **Ekonomite e shkalles**

Ekonomite e shkalles perfitohen kur kostoja per njesi e sherbimit zvogelohet me rritjen e sasise se sherbimit. Ne ofrimin e sherbimeve te telekomunikacioneve, ekonomite e shkalles jane te konsiderueshme, dhe kjo perben nje pengese per operatore te rinj per te konkurruar me nje operator me rrjet te shtrire ne te gjithe territorin e nje vendi. Operatori Albtelecom si operator i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me operatoret alternative dhe celulare dhe operatore te rinj te mundshem ne treg, per ofrimin e linjave lokale te telefonise fikse, te linjave me qera dhe ne kete menyre edhe per ofrimin e aksesit ne broadband te bazuar ne kete rrjet dhe ne teknologjite qe mbeshteten mbi kete rrjet.

Albtelekom duke patur nje rrjet infrastrukturor backbone edhe ne tregun e aksesit ne broadband trashregon nje status te tille. Dimensionin e shtrirjes se rrjetit perben nje pozicion dominant ne raport me sipermarres te tjere ne kete treg. Rrjetet mobile te Vodafone Albania , AMC dhe Eagle Mobile qe sipas te dhenave te evidentuara per kete analize ofrojne akses ne broadband bazuar ne teknologjine GPRS dhe EDGE, nepermjet SIM Card dhe Card Modem, rezultojne te ofrojne produkte dhe sherbime te limituara dhe jo ekuivalente me sherbimet qe ofrojne ISP –te bazuar ne teknologji te tjera, duke mos u konsideruar si te zevendesueshme (sipas karakteristikave funksionale dhe ne termat e cmimit) pavaresisht disa avantazheve si (avantazhi i levizshmerise, pa kablllo, priza e tela, etj).

*Si konkluzion themi qe:*

*Albtelekom ka prezence me nje infrastrukture me kapacitet ne shtrirje gjeografike ne ofrimin e ketij sherbimi dhe si rrjedhoje kjo perben nje avantazh te Albtelekom ne raport me ofruesit e tjere te aksesit ne broadband.*

### **Ekonomite e densitetit**

Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh ne ofrimin e aksesit ne broadband. Albtelecom ka qene i vetmi operator rrjeti i lejuar te ndertoje rrjet ne zonat urbane te cilat jane zona me dendesi shume me te madhe se zonat rurale. Me liberalizimin e tregut ne zonat urbane kete avantazh e kane edhe operatoret qe investojne ne keto zona ne krahasim me operatoret ne zonat rurale.

---

<sup>4</sup> Avantazhe te permendura edhe ne Analize 2007 dhe 2009 te telefonise fikse, dhe ne 2009 te Linjave me Qera

## **Integrimi vertikal**

Prezenca e nje operatori ne dy nivele te tregjeve, me shumice dhe me pakice, d.m.th. integrimi vertikal rrit aftesine ndikuese ne treg te operatorit. Operatoret e rrjeteve telefonike publike jane vertikalisht te integruar. Nje integrim i tille eshte argumentuar ne te gjitha analizat e tregut qe nga 2007, 2009 te cilat kane gjetur Albtelecom me FN ne tregjet e analizuara. Avantazhet e krijuara nga madhesia e rrjetit (niveli me shumice), prezenca me linja abonentesh ne te gjitha rrethet e RSH (niveli me pakice) te operatorit Albtelecom jane shume me te medha se ato te operatoreve te tjere (rurale) dhe operatoreve te rinj te mundshem ne treg. Nje operator vertikalisht i integruar, ka mundesine qe te krijojte avantazhe (diskriminoje) per pjesen e tij te ofrimit te sherbimeve ne nivelin me pakice ndaj konkurrenteve te tjere per keto tregje perkatese me pakice, duke perdorur aftesine ndikuese ne nivelin (tregjet) me shumice, pra duke ofruar sherbimet (inpute per tregjet me pakice) ne nivelin me shumice konkurrenteve te tij me cmime me te larta se ai ofron per pjesen e vet te tregut me pakice

Avantazh tjetër i Albtelecom ne ofrimin e aksesit ne broadband eshte:

Mbulimi i kufizuar territorial nga operatoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem me Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar akses ne lidhje te dedikuara apo te bazuar ne teknologjine x DSL ne zona te ndryshme gjeografike.

Aftesia e konkurrences se mundshme ne kete treg, ne formen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurruese te operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me Albtelecom ne ofrimin e aksesit ne broadband, eshte i madh.

*Megjithë eliminimin apo reduktimin e ndjeshëm të pengesave ligjore, që erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator të Autorizimeve të Përgjithshme, Albtelecom vazhdon të ketë avantazhe ndaj operatoreve të tjerë për shkak të ekonomive të shkallës, ekonomive të densitetit, integritit vertikal. Këto avantazhe të Albtelecom, në rrjetin lokal dhe backbone, ndikojnë pozitivisht në aftesine ndikuese të Albtelecom në tregun e shumicës të aksesit në broadband dhe për rrjedhojë duke e transferuar këtë FN edhe në tregun e pakicës.*

### **III.Fuqia kundervepruese e bleresve te linjave me qera si nje nder menytrat kryesore per akses ne tregun e shumices te aksesit ne broadband**

Pozita e nje operatori, qe eshte dominant ne ofrimin e nje sherbimi, mund te jete me e dobet nese egzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit

te shitesit per te mos humbur kete klient. Ne analizen e Linjave me Qera eshte bere e qarte se blesesit me pakice te linjave me qera jane kompani apo institucione te cilat kane nevojte te lidhin ambiente te ndryshme nepermjet kapaciteteve te dedikuara. Ofrimi i linjave me qera eshte i varur nga vendodhja e ambienteve qe do lidhen, dhe avantazhet e Albtelecom te lidhur me prezencen me rrjet ne nivel kombetar, ulin aftesine negociuese te blesesve, pasi Albtelecom shpesh eshte i vetmi operator qe mund te siguroje sherbimin e kerkuar nga blesesi. Por Linjat me qera ne tregun e shumices te aksesit ne broadband konsiderohen mjaft te rendesishme pasi mundesojne transferimin e te dhenave ne menyre simetrike nga pika e aksesit ne tregun e shumices deri ne ndertesesh e klientit, apo ISP. Ndaj lidhjet e dedikuara zene vend te rendesishem ne aksesin e realizuar ne tregun e shumices ne broadband.

Fuqia kundervepruese ekziston ne tregun e shumices ne rast se operatori qe zoteron nje pozite te forte ekonomike, reflekton ne treg rritje te cmimit te aksesit dhe sherbimeve ne tregun e shumices dhe ne se fuqia negociuese e operatoreve te aksesuar ne kete treg nuk mjafton per te ndryshuar cmimin e ngritur, percakton nje pozicion me fuqi kundervepruese te dobet ne kete treg.

Ndaj per vete dimensionin qe ka Albtelekom, per shtrirjen gjeografike, ashtu sic edhe evidentohet nga te dhenat, rezulton se ka nje peshe te konsiderueshme ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, per te gjitha avantazhet e detajuara me siper.

### **Tarifimi i linjave te aksesit ne tregun me shumice te aksesit ne broadband per lidhjet e dedikuara apo linjat me qera**

AKEP sapo ka perfunduar analizen e linjave me qera (per tregjet ne nivel pakice dhe shumice) dhe nje nder konkluzionet e arritura ne kete analize eshte mungesa e dallimit qe ben Albtelekom ne menyren e tarifimit te ketyre linjave per shitjen me shumice dhe me pakice te tyre, duke aplikuar te njejtat tarifa per qarqet kombetare, dhe tarifa me te larta per qarqet nderkombetare te dhena operatoreve te telekomunikacioneve (pra shitje me shumice) se perdoruesve fundore te tyre (kompani jo telekomunikacioni). Ne perfundimet e arritura ne kete analize nga gjetja e Albtelecom me FN ne tregjet e analizuara, jane percaktuar detyrime rregullatore qe kane lidhje me rregullimin e ketyre tarifave ne tregun e shumices duke perdorur metoden benchmark sipas referencave te pranueshme ne praktikate rregullatore.

Per me ne detaje shiko detyrimet rregullatore te vendosura sipas analizes (seksionin VI ne Analizen e Linjave me Qera).

#### IV. Krahasime te broadband ne Shqiperi me vendet e rajonit dhe te BE-se

Ne figurat e meposhtme prezantohen krahasime te ndryshme te aksesit ne broadband sipas teknologjive, per operatoret (incumbent dhe hyrjet e reja), tarifimi mujor ne kapacitete te ndryshme si dhe tendenca e zhvillimit te tregut ne broadband. Duhet sjelle ne vemendje se grafiket e paraqitur nga Cullen International perfshijne te dhena te evidentuara deri ne korrik 2009, por duke patur parasysh qe tregu broadband eshte nje nga tregjet e tregut te komunikimeve elektronike qe po leviz me me shpejtesi, rezulton qe ne periudhen e dyte 6 mujore te 2009 ne disa nga parametrat qe prezantohet Shqiperia nuk perputhen me situaten reale. Por gjithesesi duke qene se ndryshimi nuk eshte shume i madh, grafiket ne figurat me poshte tregojne situaten krahasuese te Shqiperise me vendet e rajonit dhe te EU-27.




Figure 5 - Broadband penetration rate, July 2009




Figure 6 - Fixed retail broadband connections by incumbent and alternative operators






Figure 7 - Competition in retail xDSL




Figure 8 - Fixed retail broadband connections by technology




Figure 5 - Broadband 512 kbps monthly subscription charges in euro, including VAT




Figure 6 - Broadband 1 Mbps monthly subscription charges in euro, including VAT





Figure 79 - Broadband 2 Mbps monthly subscription charges in euro, including VAT


**Aksesi ne Broadband ne EU-27 dhe tendenca e ketij tregu ne vitet 2003-2008 si dhe referenca te ndarjes se tregut sipas teknologjive dhe operatoreve ne kete treg.**

- ✓ Ndarja e tregut per EU-27 per linjat e aksesit ne broadband ne total sipas operatoreve (korrik 2008)




**Fig.1 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)**

- ✓ Ndarja e tregut per EU-27 per linjat e aksesit ne broadband ne total sipas teknologjive (korrik 2008)



**Fig.2 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)**

- ✓ Ndarja e tregut per EU-27 per linjat e aksesit ne broadband per teknologjine DSL (korrik 2008)



**Fig.3 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)**

- ✓ Ndarja e tregut per EU-27 per linjat e aksesit ne broadband per teknologjine te tjera te ndryshme nga DSL (korrik 2008)




Fig.4 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)

- ✓ Trendi i tregut per aksesin ne broadband per totalin e linjave te aksesit te operatoreve incumbent ne EU-27 (2003-2008)




Fig.5 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)

- ✓ Trendi i tregut per aksesin ne broadband per totalin e linjave te aksesit per teknologjine DSL ne EU-27 (2003-2008)




Fig.6 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)

- ✓ Trendi i tregut per aksesin ne broadband te bazuar ne teknologjine DSL ne EU-27 (2003-2008) per Hyrjet e Reja




Fig.7 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)

- ✓ Ndarjet e tregut per operatorët e rinj te hyre ne treg mbeshtetur ne DSL, sipas tipit te aksesit te realizuar ne EU-27 ne korrik 2008




Fig.8 Burimi: Information Society and Media Directorate-General (Broadbands access in the EU - July 2008)

### Informacioni nje element i domosdoshem ne tregun e aksesit ne broadband

Informacioni si nje element i rendesishem qe favorizon sipermarresit ne tregun e komunikimeve elektronike eshte ne rastin me te mire konfuz, duke mos perjashtuar mundesine e fshehjes se informacionit per infrastrukturen e rrjetit, teknologjite perkatese dhe pikat e mundshme te aksesit

per sipermarresit qe kane te ngritura rrjete dhe ofrojne sherbime bazuar ne rrjetet e tyre. Megjithese Albtelekom eshte OFNT sipas analizave 2007 dhe 2009 ne tregjet e cituara me siper ne kete analize, dhe pavaresisht ecurise ne drejtim pozitiv ne publikimin e informacionit perkates dhe RIO-s te publikuar, perseri konsiderohet si nje element qe ka nevojte per rritje te transparences dhe suport te nevojshem ne kete drejtim.

### **Në fazën e tregut përkatës**

Tregu i aksesit ne broadband ne nivel shumice eshte ne nje faze zhvillimi te pakonsoliduar dhe konfuz. Pavaresisht nevojave imediate per te zhvilluar kete treg, egzistojne faktore qe ndikojne negativisht ne aftesine e operatoreve te rinj per te hyre ne kete treg qofte me infrastrukture paralele qe konkuron Albtelekom vetem ne nivel shumice, ne te njejten kohe edhe ne futjen e teknologjive te reja qe mundesojne zgjidhje teknike per akses ne broadband pa u mbeshtetur ne rrjetin fiks te telefonise, apo ne rrjete fizike qe kane nevojten e rrjeteve backbone. Duke gjykuar kete faze ne te cilen ndodhet zhvillimi aktual i ketij tregu, rezulton qe Albtelecom ka avantazh te pakten ne kete faze zhvillimi te ketij tregu. Polikat per zhvillimin e tregut broadband ne nje te ardhme te shkurter mund te ndryshoje kete konkluzion, por ne mungese te WIMAX dhe UMTS aktualisht ky faktor nuk duhet neglizhuar.

### **Kontrolli mbi infrastrukturen**

Albtelekom per te gjitha arsyet e perseritura jo vetem ne kete analize, por edhe ne analizat e meparshme qe kane ne fokus operatorin Albtelekom eshte konkluduar qe pronesia e rrjetit, shtrirja ne shkalle kombetare, trashegimia ne vite dhe barrierat e mundshme ekonomike te cilat jane trajtuar edhe ne avantazhet e ekonomive te shkalles dhe densitetit, integrimin vertikal etj. perbejne ne vetevete nje instrument kontrollues qe ka Albtelekom mbi rrjetin dhe infrastrukturen e tij.

### **Tarifat ne tregun e shumices te aksesit ne broadband per kapacitetin 1Mbps**

Duke shprehur shqetesimin e AKEP per plotesimin e pyetesoreve nga sipermarresit e sherbimit te internetit, gjithesesi shifrat e dhena do te konsiderohen te sakta, ne vijim do te pershkruajme vlerat e tarifave per broadband per kapacitet 1Mbps, kryesisht per lidhjet me fiber si dhe lidhje fikse mikrovalore. Per operatoret kryesore te aksesuar ne tregun nderkombetar si Albtelekom, Abcom, Abissnet, ASC, dhe Primo te cilet deklarojne tarifen e blerjes te aksesit per kapacitetin e kontraktuar rezulton se, sipas pyetesoreve te plotesuar nje pjese e ISP-ve qe aksesohen ne tregun e shumices ne Shqiperi (tek Albtelekom, Abcom, Abissnet, Primo dhe ASC) deklarojne tarifate e blerjes se ketij aksesit sipas llojit te aksesit (tipit te lidhjes). Nga kjo vihet re se ne tregun e shumices ka nje diskriminim ne tarifate e ofruara per te njejtin tip lidhje ne varesit te operatoreve.

Ne nje vezhgim te operatoreve qe jane te aksesuar tek Albtelecom (sipas te dhenave te pyetesoreve, 24 te tille), rezulton qe lidhjet kryesore qe mundesojne aksesin ne broadband ne tregun e shumices jane: a) lidhje kablllore; lidhje me fiber; lidhje mikrovalore; Nga 6 operatoret qe jane te aksesuar ne tregun nderkombetar, 3 prej tyre sigurojne akses edhe tek Albtelecom dhe me pas ofrojne kete akses ne tregun e pakices. ISP-te qe marrin kete akses tek

Albtelekom (24 te tille), tek Abissnet( 5 te tille) , Abcom (3 te tille), Primo (3 te tille), nje vleresim i tille behet duke verifikuar pyetsoret, por duhet theksuar fakti qe nje pjese e mire e tyre nuk pergjigjen ne lidhje me faktin se ku jane te aksesuar dhe kush jane tarifat qe ata paguajne per aksesin e realizuar. Ne tabelen me poshte jane te grupuara elementet e pershkruar me siper, ne te cilen jane dhene 6 operatoret qe kane deklaruar se kane akses ne tregun nderkombetar, menyren e aksesit te realizuar, tarifa qe e kane te kontraktuar kete akses (dhe eshte llogaritur tarifa per 1 Mbps/muaj), si dhe duke evidentuar pyetsoret rezulton qe ne shitje ka nje luhajte te konsiderueshme te tarifave per 1 Mbps sipas lidhjes me fiber apo lidhje mikrovalore per operatore te ndryshem qe kerkojne akses ne kete treg. Rezulton qe tarifat e Albtelecom mund te luhaten nga 72 euro/muaj per Mbps deri ne rreth 400 euro/muaj per Mbps. Sipas evidentimeve te bera rezulton se jane kontraktuar nga nje sipermarres 300 Mbps tek Albtelecom dhe kjo perben edhe rastin e ofrimit te tarifes prj 72 euro/Mbps ne muaj.

Mungesa e nje strukture te rregullt tarifore te ofruar nga Albtelecom per sipemarresit qe kerkojne akses ne tregun e shumices me qellim qe me pas ta rishesin ne tregun e pakices si dhe prezenca me infrastructure mbizoteruese ne raport me sipemarresit e tjere, te krijon bindjen se Albtelecom mund te vendose tarifa ne varesi edhe te planeve te zhvillimit te biznesit te tij per zona te caktuara, duke dekurajuar jo vetem hyrjet e mundshme te reja, por edhe per sipemarsit egzitues duke u eliminuar mundesit e zgjerimit te tyre si dhe duke zbehur efektin e konkureses se tyre ne tregun e pakices.

### **Aksesi ne tregun e shumices si dhe tarifat ne blerje dhe ne shitje per kapacitetin 1Mbps per ISP-te qe aksesohen ne kete treg**

Nr	Akses Nderkombetar	Lloji lidhjes	Tarifa e blerjes per 1 Mbps (euro/muaj)	Tarifa e shitjes ne tregun e shumices per 1 Mbps (euro/muaj)
1	Albtelekom	Lidhje me fiber	28	72 deri ne 400 euro/muaj
2	Abcom	Lidhje me fiber	70	120 euro/muaj
3	Abissnet	Lidhje me fiber	80	deri ne 250 euro/muaj
4	Primo	Lidhje fiber + mikrovalore	N/A	deri ne 160 euro/muaj
5	ASC	Lidhje fikse mikorovalore	78	N/A
6	Itirana sh.p.k	Lidhje fikse mikorovalore	65	deri 170 euro/muaj

**Konkluzion i AKEP per egzistencen e Fuqise se Ndjeshme te Albtelekom ne tregun e shumices te aksesit ne broadband**

*AKEP konsideron qe tregu i shumices te aksesit ne broadband nuk eshte ne konkurence efektive dhe vlereson qe Albtelecom ka FN ne kete treg, d.m.th qe ka nje pozicion dominues ne zhvillimin e ketij tregu.*

*AKEP, ka analizuar faktoret ne perputhje me Nenin 33 te Ligjit, duke argumentuar se Albtelecom ka nje kontroll mbi infrastrukturen baze qe mundeson zhvillimin e konkureses efektive te ketij tregu te bazuar ne madhesine e rrjetit, fuqine e ulet kundervepruese te bleresve, ekonomine e shkalles dhe te dendesise, integrimin vertikal etj. Bazuar ne keta faktore te rendesishem si dhe ne matjet e tregut ne %, te aksesit ne broadband sipas teknologjive kryesore rezulton se: Albtelekom ka pozicion dominant ne kete treg, d.m.th eshte me FN ne tregun e shumices te aksesit ne broadband.*

## **V.Perfundime mbi FNT per tregun e shumices te aksesit ne broadband**

Sipas analizes se bere per faktoret e marre ne konsiderate ne lidhje me fuqine e ndjeshme ne treg, rezulton se:

- Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 50% te aksesit ne broadband ne nivel shumice.
- Albtelecom eshte aktualisht operator me FNT ne tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe eshte gjetur si OFNT edhe ne “Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: versioni perfundimtar”, perfunduar ne vitin 2009, si dhe ne Analizen e Linjave me Qera ne tregun e pakice dhe te shumices te perfunduar ne Janar 2010
- Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rendesishem per te shtrire FNT ne tregun me shumice te aksesit ne broadband dhe potencialisht i mundshem per te transferuar kete FN ne tregun e pakices te aksesit ne broadband.
- Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me hyrjet e reja ne tregun e aksesit ne broadband.
- Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh edhe ne ofrimin e aksesit ne broadband.
- Mbulimi i kufizuar territorial nga operatoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem me Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar akses ne broadband bazuar mbi rrjetin fikse te telefonise apo lidhje te dedikuara ne zona te ndryshme gjeografike.
- Aftesia e konkureses se mundshme ne kete treg, ne formen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurruese te operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me Albtelecom ne ofrimin e aksesit ne broadband.



- *Megjithë eliminimin apo reduktimin e ndjeshëm të pengesave ligjore, që erdhi si pasojë e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator të Autorizimeve të Përgjithshme, Albtelecom vazhdon të ketë avantazhe ndaj operatoreve të tjerë për shkak të ekonomive të shkallës, ekonomive të densitetit, integritetit vertikal. Këto avantazhe të Albtelecom, në rrjetin lokal dhe backbone, ndikojnë pozitivisht në aftësinë ndikuese të Albtelecom në tregun me shumicë të aksesit në broadband.*

*Per rrjedhojë duke gjykuar si të mjaftueshëm argumentet e renditur më sipër, AKEP konsideron se:*

**Albtelecom përmbush kriteret për fuqi të ndjeshme në tregun perkates me shumicë të aksesit në broadband duke e propozuar sipas kësaj analize si OFNT.**

## **V. MASAT RREGULLUESE PER FNT NE TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND**

AKEP gjykon se ne mungese te rregullimit, problemet e mundshme qe do te ndikojne ne konkurrencen efektive ne tregun e shumices te aksesit ne broadband do te sponstonin ne kohe nje nderhyrje te mevonshme, pavaresisht fazes ne te cilin ndodhet tregu i broadband ne Shqiperi. Kjo gjykohet edhe nisur nga objektivat politike te Qeverise, per te rritur penetrimin ne broadband te shqiptareve si dhe per rritur gamen e produkteve dhe sherbimeve qe mundeson aksesin ne broadband. Ne kete drejtim po konsiderohen politika te tilla zhvillimi per te stimuluar teknologji te reja si WIMAX, UMTS etj, te cilat ne nje kohe te shkurter te percaktojne zhvillimin e ketij tregu. Por duke konsideruar disavantazhet qe vijne si pasoje e penetrimin te ulet (11.3%) te aksesit ne telefonine fikse, gje e cila e pengon rritjen e shpejte te aksesit ne broadband bazuar mbi teknologjine x DSL, apo teknologji te tjera qe mbesheten ne rrjetin fikse te telefonise, duhen shfrytëzuar teknologji te tjera qe zevendesojne apo eliminojne efektet e disavantazhit te cituar me siper, dhe ne kete drejtim shfrytëzimi me efikasitetin e rrjetit backbone te Albtelekom, duhet konsideruar ne menyre racionale si hapi i pare ne zhvillimin e ketij tregu.

Sjellja e operatoreve qe kane FN ne kete treg duhet konsideruar ne dem te konkurrences efektive, te mundesise per te hyre operatore te rinj ne kete treg si dhe te mundesive reale per te ndertuar rrjete paralele qe favoriozjne aksesin ne broadband.

Analiza e kryer do te fokusohet ne gjetjen e problemeve reale qe ndikojne ne rritjen e konkurrences efektive, dhe ne perputhje me keto probleme do te percaktohen edhe masa rregulluese te cilat ne cdo rast duhet do te jene te justifikuar dhe ne raport me gjetjet e analizës. Ketu duhet theksuar fakti qe per te gjitha arsyet dhe argumentimet e mesipeme rezultojne se Albtelekom edhe pse eshte nje operator me FN ne disa tregje te cilat jane te bazuara ne kete rrjet dhe ne te njejten infrastrukture qe ka ky operator dhe per rrjedhoje nje pjese e masave detyruese qe do te percaktohen per Albtelekom jane te trajtuara edhe ne analizat e tregut te telefonise fikse (2009) si dhe ne analizen e tregut te linjave me qera (2009).

### **V.1 Problemet e konkurrences ne tregun e shumices te aksesit ne broadband**

Ne analizat e tregjeve te zhvilluara nga Rregullatoret Europiane ne lidhje me aksesin ne broadband ne tregun e shumices, rezultojne se ka ngjashmeri ne lidhje me problemet e identifikuar ne keto tregje dhe per pasoje ne nje menyre apo tjeter, probleme te tilla shfaqen ne te gjitha vendet. Tregu broadband ka njohur zhvillime pothuajse te njekohshme ne te gjitha vendet dhe eshte bazuar ne te njejtat teknologji, kryesisht te suportuara nga rrjetet e operatoreve incumbent te cilet gezonin nje trashëgimi ne infrastruktura e tyre. Krahas inkurajimit te futjeve te reja ne kete treg, jane konsideruar si te domosdoshme edhe krjimi i hapësirave te mundshme apo me sakte shfrytëzimi i kapaciteteve infrastrukturore ekzistuese qe bazohen ne teknologjite te cilat favoriozjne aksesin ne broadband.

Ne analizat e kryera dhe gjetja sipas tyre e operatoreve me FNT, nder te tjera kane percaktuar disa nder problemet e evidentuara si me te qenesishme dhe si te tilla jane vecuar:

- Integrimi vertikal;
- Integrimi horizontal;

- Dominanca individuale;

Sejcili nga keto probleme ne vetvete permban elemente te tjere konkret te cilet ndikojne ne zhvillimin e konkureses efektive dhe qe duhen trajtuar si faktore pengues.

Grupi i Rregullatoreve Europiane (ERG) ne dokumentin , ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006, citon se per shkak te mundesive dhe stimujve te krijura nga transmetimi i FNT vertikalisht apo horizontalisht, si dhe nga dominanca individuale e nje operatori ne treg, shpesh egzistojne dhe lindin probleme per konkurrencen, te lidhura me cmimin ose jo, si:

- refuzimi per te dhene akses;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- tarifa shume te larta;
- diskriminim ne tarifa dhe cilesi;
- subvencionim i terthorte;
- investim i tepert apo i manget;
- dhenia e sherbimeve me shporta (bashkimi i sherbimeve) etj

Transmetimi i FNT (Leveraging of market power), eshte cdo sjellje nepermjet te ciles nje operator qe ka FNT ne nje treg, transmeton (transferon) fuqine e ndjeshme ne kete treg ne nje treg tjetër i cili eshte potencialisht konkurrues. Transmetimi i FNT mund te jete vertikal ose horizontal, ne varesi te niveleve te te dy tregjeve: nese dy tregjet jane ne te njejtin nivel, transmetimi i FNT eshte horizontal, nese nje prej tregjeve eshte ne nivel me pakice dhe tjetri ne nivel me shumice transmetimi eshte vertikal. Transmetim i fuqise se ndjeshme eshte nje perpjekje (sjellje strategjike) e operatorit OFNT per te nxjerre jashte tregut potencialisht konkurrues rivalet e tij.

Albtelecom sipas kesaj analize eshte shpallur operator me fuqi te ndjeshme ne tregun me shumice te aksesit ne broadband, dhe nje nder arsyet e FNT eshte permendur integrimi vertikal i Albtelecom dhe prezenca ne te dy nivelet e tregjeve. Albtelecom per shkak te FNT ne tregun me shumice te aksesit ne broadband ka mundesine ta transmetoje kete FNT edhe ne tregun me pakice te aksesit ne broadband.

## **V.2 Masat Rregulluese per Albtelekom**

Ne baze te parashikimeve te ligjit, neni 34, *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo*

*vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe se detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet të jene proporcionale me masen e problemit dhe të mos jene barre e tepert per operatorin.

Bazuar ne pershkrimin e problematikes se cituar me siper, AKEP gjykon se masat e nevojshme qe duhen propozuar ne kete draft analize per t'u vendosur ndaj Albtelecom, me reference ne parashikimet e Ligjit 9918, jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

## **ANEKS 1. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIMI ME PUBLIKUN PER TREGUN E SHUMICES TE AKSESIT NE BROADBAND**

**Me poshte eshte nje permbledhje e pyetjeve per te cilat AKEP eshte i interesuar te marre komente nga palet e interesuara. Palet mund te japin komente edhe per pjese te tjera te dokumentit te analizes dhe perfundimeve te AKEP.**

1. A mendoni se teknologjite e pershkruara qe mundesone akses ne tregun e pakices jane prezent aktualisht ne Shqiperi? Ju lutem jepni arsyetimin tuaj.
2. A mendoni se ne Shqiperi ofrimi i sherbimit te Internetit per perdoruesit fundore eshte konkurrues?
3. A jeni dakort me konkluzionin e arritur ne kete analize se aksesit ne tregun e shumices nuk eshte ne konkurrence efektive?
4. A mendoni se ofrimi i sherbimeve me shumice te Internetit (aksesi ne rjetin global) eshte konkurrues?
5. A mendoni se tarifat qe ofrohen per akses ne tregun e shumices jane te arsyeshme, apo jane te larta?
6. A mendoni se Albtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregun me shumice te aksesit ne broadband?
7. A mendoni se detyrimet e propozuara te AKEP per FNT te Albtelecom jane te arsyeshme/te mjaftueshme per te eliminuar problemet ne tregun e shumices te aksesit ne broadband?
8. Cfare masash te tjera rregullatore mendoni se jane te nevojshme per aksesin ne broadband ne nivel shumice?

## **VI. TREGU SHUMICES TE AKSESIT FIZIK NE INFRASTRUKTUREN E RRJETEVE NGA NJE VENDODHJE FIKSE (perfshire aksesin e ndare dhe te plote)**

Tregu i shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjeteve, sipas Rekomandimit 2003 eshte tregu i 11 ne listen e tregjeve, ndersa ne Rekomandimin e 2007 eshte tregu i 4-et ne kete liste te tregjeve. Bazuar ne Rregulloren e Analizes, miratuar nga AKEP me VKD Nr.747 dt.17.07.2009, ne nenin 3 te kesaj rregulloreje “Lista e Tregjeve” , ky treg eshte i renditur si tregu 14 per t’u analizuar nga AKEP. Ne nenin 3, pika 4 e kesaj rregulloreje percaktohet qe:

Nese nje treg i analizuar nga AKEP nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), atehere AKEP vlereson gjithashtu nese ky treg ploteson tre kriteret e meposhteme :

- I. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;
- II. nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe
- III. pamajftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

Ndaj per sa siper, AKEP ka detyrimin e perkufizimit dhe te percaktimit te dimensionit gjeografik te ketij tregu si dhe analizen e tij per Fuqi te Ndjeshme, duke konsideruar te panevojshme vleresimin e tre kriterëve te renditura me siper.

### **I. Dimensioni produkteve dhe sherbimeve te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve**

Sherbimi i unbundled akses ne local loop ne dy versionet e saja (full dhe shared) perben ndryshim per faktin qe ne version “full” mundesohet per operatorin qe te perdore te dhenat zanore dhe te dhenat per internet ( nje perdorim te plote te aksesit) d.m.th banden zanore e cila eshte ne perdorim nga operatori incumbent per pajtimtaret e tij dhe (copper loop) per transmetim te dhenash, ndersa ne version “shared” lejohet te perdore vetem (copper loop) per transmetim te dhenash dhe jo banden zanore te operatorit incumbent.

Ne listen e tregjeve te parashikuar ne Rekomandimin e BE-se te 2003 dhe 2007, jane parashikuara si dy tregje te ndara per rregullime ex-ante, sherbimi i aksesit ne broadband ne tregun e shumices dhe sherbimi i aksesit ne unbundled ne tregun e shumices. Nje operator qe deshiron te furnizoje ne tregun e pakices akses ne broadband i cili ka akses ne broadband ne tregun e shumices i mundeson atij sherbime ekuivalente per perdoruesin ne tregun e pakices edhe edhe duke qene i aksesuar ne tregun e shumices ne unbundled local loop.

Sherbimi unbundled akses ne local loop ne nivel shumice i mundeson operatorit te aksesuar te ofroje ne tregun e pakices duke derguar me pare kete akses ne DSLAM, dhe me pas duke furnizuar perdoruesin fundor me sherbimet e plota. Karakteristikat teknike te ketij sherbimi si shpejtesia etj, jane te lejuara nga operatori incumbent kundrejt percaktimeve teknike qe parashikohen me pare.

Elemente të tjera që ndikojnë në këtë shërbim janë: zona gjeografike ku do të ofrohet shërbimi për përdoruesit fundor në të cilën do të instalohet edhe DSLAM për të lejuar me pas daljet e mundshme që të aksesohet përdoruesi fundor dhe ka ngjashmëri me shërbimin bitstream akses në të cilën perseri operatori incumbent përcakton planin e zhvillimit të rrjetit të operatorit që aksesohet në nivel shumice.

Operatori ofertues në tregun e pakicës i cili është aksesuar në nivel shumice në rrjetin e operatorit incumbent është i kushtëzuar në karakteristikat teknike të shërbimit që i mundëson përdoruesit fundor dhe ndër të tjera varet edhe nga pozicioni gjeografik që ka përdoruesi fundor me pikën e aksesit në DSLAM (në vendin ku DSLAM është instaluar).

Më fjale të tjera ashtu si në ofrimin e shërbimit bitstream akses edhe në ofrimin e shërbimit unbundled local loop, operatori i aksesuar në nivel shumice nuk ka kontroll të plote mbi aksesin e ofruar për përdoruesin fundor. Për rrjedhojë shërbimi i aksesit në unbundled në local loop në lidhje me krahasimin e plote të cmimit dhe funksionalitetit, nuk mund të konsiderohet plotësisht i zëvendësueshem, ose me saktë nuk është pjesë e të njëjtit treg. Ndaj edhe në rekomanimet përkatëse është parashikuar të analizohen si tregje të vecanta.

### **Local Loop**

Rrjetet e aksesit janë ndërtuar në mënyrë të tillë prej kabllorëve (filleve) të shumefishta të bakrit (tela bakri të çiftuar). Këto rrjete zhvillohen (evoluojnë) në varesi të kërkesave për shërbime që bazohen mbi këto rrjete. Zanafillen e vet këto shërbime e kanë tek kërkesat që gjenerohen nga përdoruesi fundor, si shërbime në broadband të bazuara në teknologjinë DSL (Digital Subscriber Loop)

Local Loop ose ndryshe që mundëson akses në rrjetin e përdoruesve të rrjetit fikse në një nyjë të këtij rrjeti që zakonisht njihet si nyjë në centralin lokal të telefonisë.

Pothuajse në të gjitha rastet rrjetet e aksesit të ndërtuara nga përdorimi i bakrit janë zotëruar nga operatorët incumbent që ose kanë qenë nën administrimin e qeverisë ose në rastin më të mirë në aksione (shtet + privat) ose janë të organizuara 100% si kompani private.

### **Unbundling**

Në tregun e komunikimeve elektronike kërkesa për “unbundling” është përcaktuar si një kërkesë rregullatore që mundëson furnizimin me shërbime për konkurrencën duke u aksesuar, përdorur apo blerë elementet e rrjetit të operatorit incumbent, duke mundësuar në këtë mënyrë furnizimin me shërbime për përdoruesit fundor që janë të lidhur në rrjet. Në tregun e broadband egzistojnë dy tipe baze të aksesit në elementet e rrjetit unbundling:

- Bitstream
- Local Loop Unbundling

## Local Loop Unbundling

LLU është një zgjidhje që ka si qëllim rritjen e nivelit të konkurrencës në furnizimin e aksesit në internet dhe kërkesave për shërbime nga broadband. Hyrjet e reja në treg (operatorët e rinj) kanë nevojë dhe tentojnë të plotësojnë nevojat me kërkesa dhe shërbime të përdoruesit fundor dhe këto e sigurojnë vetëm pasi të kenë rrjetin e aksesit, të cilin e realizojnë ose duke e ndërtuar vetë, ose duke përdorur infrastrukturën e egzistuese të operatorit incumbent. Ndërtimi i infrastrukturave në përgjithësi është i bazuar në kosto të larta, ndaj përvojat e deritanishme kanë përcaktuar si me ekonomike dhe në një kohë me të shkurtra shfrytëzimin e infrastrukturave egzistuese të operatorit incumbent. Politikat rregullatore ndërkombëtare kërkojnë që operatorët incumbent që zotërojnë rrjetet infrastrukturore bakri të konsiderohen si OFNT duke përcaktuar detyrime rregullatore për të ofruar për operatorët e tjerë unbundled akses në local loop, si dhe duke mundësuar për këta të fundit facilitete dhe bashkëvendosje për pajisjet në ndërtuesat që zotërojnë operatorët incumbent.

Në një përshkrim të shkurtra për LLU mund të themi që:

- Është më e komplikuar se thjesht interkoneksioni në rrjet;
- Kërkon veprime operacionale dhe komerciale;
- Kërkon investime;
- Mund të interferojë në rrjetin egzistues;
- Kërkesat dhe nevojat duhen menaxhuar me kujdes;

LLU lejon një furnizues të shërbimeve broadband të mundësojë shërbimet e broadband për klientet e vet të lidhur në pajisje x DSL në fille dyshe bakri të aksesuar në rrjet.

LLU gjithashtu lejon operatorin LLU të bashkëvendosin pajisjet që zotërojnë si operator i aksesuar në rrjet. Zhvillimi i teknologjisë DSL ka krijuar mundësi për bandwidth të lartë që varion nga 256 kbps deri në 10 Mbps downstream, për ta dërguar tek përdoruesi fundor që bazohet në DSL të aksesuar në rrjetin e ndërtuar me fille bakri.

LLU ka gjetur një shtrirje në rang ndërkombëtar, por duhet theksuar se:

- Operatorët incumbent pengojnë dhe nuk e realizojnë atë në mënyrë vullnetare;
- Implementimi LLU-se kërkon ndërhyrje rregullatore të bazuar në legjislacionin vendas.

Operatorit incumbent për rrjedhojë i duhet kërkuar që të mundësojë:



- Ngritjen e linjave te reja per sherbimin LLU dhe tarifimin te orientuar drejt kostove baze;
- Publikimin e ORU (Oferte Reference Unbundling) duke e shoqeruar me listen e cmimeve te miratuara nga rregullatori;
- Percaktimin e LLU si nje sherbim te ri ne listen e sherbimeve te ofruara;
- Nderhyrjen ne sistemin e pergjithshem te sherbimeve duke futur te gjitha sherbimet qe gjenerohen nga aksesin ne LLU;

### **MPF (Metallic Path Facility)**

Metallic Path Facility (MPF) – jane fille dyshe telash (zakonisht bakri) qe furnizojne lidhjet fizike ndermjet MDF dhe pajisjeve terminuese ne ndertesën e pajtimtarit. MPF mund te jete ne formen e “full loop” prej MDF ne ndertesën e klientit, ose “sub loop” prej nje pike ndermjetese ne rrjet deri tek klienti.

### **Perkufizime te Pergjithshme te Rrjetit Lokal**

**Rrjet lokal** do te konsiderohet teresia e qarqeve të pajisjeve te ndryshme të rrjetit publik të telefonisë fikse ne te cilin jane te lidhura pikat fundore të rrjetit nga nje vendodhje fikse e pajtimtarit me permutatorin (MDF) apo me ndonje pajisje tjetër tjetër ne kete rrjet.

**Perdorim i perbashket i hapësirave dhe fasiliteve teknike,** nenkupton qe operatori qe mundeson aksesimin per operatoret e tjere te interesuar u lejon atyre perdorimin e hapësirave fizike dhe te gjitha fasiliteve teknike, duke u lejuar atyre instalimin dhe lidhjen e pajisjeve te nevojshme për te patur akses në rrjetin lokal te ofruar

**Akses,** nenkupton te besh te vlefshme sherbimet dhe fasilitetet te nje sipermarresi tjetër sipas kushteve dhe kriterëve te percaktuara me qellim perdorimin e tyre ne sherbim te komunikimeve elektronike. Kjo do te thote, akses ne elementet e rrjetit dhe fasilitetet e tij duke perfshire lidhjet dhe perdorimin e pajisjeve ne rrjetin fiks (duke perfshire aksesin ne local loop, ne fasilitetet dhe sherbimet e nevojshme, ne infrastrukturen fizike, ne sistemin e softwareve si dhe te gjitha veprimet mbeshtetese ne keto sisteme).

**Akses në Rrjetin Lokal** nenkupton perdorimin e te njejtit rrjet lokal nga operatoret e interesuar te tregut pa gjykuar mbi pronesine e tij si dhe pa specifikuar tipin e aksesit.


**Akses i Plotë në Rrjetin Lokal** nenkupton perdorimin nga operatori i aksesuar ne kete rrjet brezin e plote te frekuencave zanore duke mundesuar per te jo vetem sherbimin e internetit por edhe ate te telefonise.


**Akses i Përbashkët (shared)** nenkupton që operatori i aksesuar në këtë rrjet përdor vetëm brezin e frekuencave jo zanore, ndërsa operatori që mundëson këtë akses vazhdon të përdorë rrjetin lokal për të siguruar shërbimin e telefonisë për pajtimtarët e tij.

*Skemat më poshtë ilustrojnë dhënie të aksesit në rrjetin lokal të hapur (shared dhe full) si dhe ilustrojnë aksesin e dhënë në rrjetet lokale të hapura, bazuar mbi PSTN.*



## LLU – Full Unbundling





### Pershkrimi i produkteve dhe sherbimeve te LLU

Produktet e identifikuar ne tregun shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit te incumbent, si: “shared akses” dhe “full akses” duhen konsideruar si produkte te pershtatshme qe mundsojne akses ne broadband. Por ne analogji me aksesin ne broadband per tregun e shumices, ne lidhje me teknologjite qe mundesojne akses ne tregun e pakices per sherbimin e aksesit ne broadband, u konstatuan se egziston kriteri i zevendesueshmerise se ketij sherbimi dhe u arrit ne konkluzionin se:

*Aksesi ne broadband ne nivelin e tregut te pakices gezon parimin e zevendesueshmerise nga ana e kerkeses dhe ofertes, pavaresisht teknologjise qe mundeson kete akses.*

Duke sjellur ne vemendje qe aksesi ne broadband ne nivelin e pakices mund te realizohet nga teknologjite si:

- a) akses me x DSL;
- b) akses me lidhje kabllore;
- c) akses me ane te linjave me qera;
- d) akses me fiber optike;
- e) akses nga rrjete celulare;
- f) akses me ane te wireless (HotSpot);
- g) akses satelitore;

Teknologjite e mesiperme qe mundesojne aksesin ne broadband ne tregun e pakices gezojne parimin e zevendesueshmerise ne kete treg (ne nivelin e pakices) dhe ne analogji me kete ne

tregun e shumices te aksesit ne broadband ne nivelin e kerkese/ofertes eshte konsideruar se zevendesueshmeria ne nivelin e shumices te aksesit ne broadband, transferon kete zevendesim ne tregun e pakices nepermjet dy menyrave:

- a) Te vetefurnizimit;
- b) Te dhenies se aksesit per te tretet ne infrastrukturen egzistuese;

Ndaj ne kete kendveshtrim rezulton se nje nder menyrat e zevendesimit ne nivelin e tregut te shumices te aksesit ne broadband eshte edhe aksesi ne LLU qe perbehet nga produktet perkatese si:

- a) akses full LLU;
- b) akses shared LLU;
- c) akses ne infrastrukturen e rrjetit te operatorit incumbent, si vetefurnizim;

Kjo perben nje zevendesueshmeri te plote ne nivelin e kerkese/ofertes per keto produkte te cilesuara me siper.

Ne percaktimin e dimensionit te produkteve dhe sherbimeve te analizuara, sipas praktikave me te mira rregullatore eshte konkluduar se ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit duhen pershire:

- a) *Te gjitha vetefurnizimet ne tregun e shumices ne LLU qe mundesohen mbi rrjete egzistuese te broadband me teknologji baze bakrin;*
- b) *Te gjitha produktet dhe sherbimet qe furnizojne te tretet (ISP-te), ne tregun e shumices ne LLU qe mundesohen mbi rrjete egzistuese te broadband me teknologji baze bakrin;*

## **II. Dimensioni gjeografik produkteve dhe sherbimeve**

Infrastruktura e rrjetit te Albtelecom e trajtuar jo vetem ne kete analize por edhe ne analizen e tregut fiks te telefonise, te analizes se linjave me qera ku eshte karakterizuar si nje infrastrukture me shtrirje kombetare, per rrjedhoje edhe ne tregun e aksesit fizik ne rrjetin local te hapur (LLU) do te gezoje statusin e shtrirjes kombetare.

Ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, Udhezimi i KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojne midis te tjerave se dimensionin gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Albtelecom , eshte ofrues i rrjetit dhe sherbimeve qe mundeson ky rrjet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ne kete menyre mund te konkludojme se:

- *Dimensioni gjeografik i sherbimit te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit (LLU) ne tregun e shumices, eshte territori i Republikes se Shqiperise.*

Per sa me me siper, percaktimi i tregut me shumice te aksesit ne broadband perfshin:

- **Tregu me shumice aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit (LLU)**
- **Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar;**

## VI.2 ANALIZA PER FNT: TREGU ME SHUMICE NE AKSESIN FIZIK LLU

Per te analizuar egzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33, ne piken 2 percaktohen nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate, dhe midis te tjerave citon:

2. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

- a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;
- b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;
- c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- ç) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;
- d) në fazën e tregut përkatës;
- dh) në përparësitë teknologjike;
- e) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;
- ë) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;
- f) në shkallën e integritit vertikal;
- g) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;
- gj) në aksesin në burimet financiare;
- h) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;
- i) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifat, paketat e shërbimeve dhe të produkteve ose vendosjen e pengesave.

Lista e kriterëve nuk është liste kumulative apo perjashtuese e kriterëve/karakteristikave të tjera për dominancë apo FNT.

### I. Pjesët e tregut

Ne mungese të të dhënave që do të analizonin se sa është % tregut që ze broadband i mundësuar nga aksesit në rrjetin e hapur lokal (LLU), krahasuar me teknologjitë e tjera, serish mund të themi që cilado të jete kjo shifer në raport me teknologjitë e tjera, 100% të saj e zoteron Albtelekom.

Ne totalin e linjave të aksesit që zoteron Albtelekom (duke perjashtuar lidhjet e mundësuar me MUX), rezulton në mënyrë hipotetike si treg i mundshëm për t'u ofruara akses për "te tretet", sipërmarres të tjere në ofrimin e shërbimit të aksesit në broadband të bazuar në LLU. Nga numri total i linjave që Albtelekom zoteron, duke konsideruar numrin e lidhjeve ADSL (aktualisht rreth 52 000 të tilla), atëherë diferenca e ngelur (Totali Linjave – Nr. Lidhjeve ADSL) janë treg i mundshëm për ofrimin e aksesit në broadband bazuar në LLU (në dy versionet full dhe shared akses).

### Si konkluzion:

*Edhe pse ne kushtet e mungeses se tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur (LLU), hipotetikisht themi qe Albtelekom zoteron 100% te tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin e hapur lokal (LLU).*

### **III. Pengesat per hyrje dhe konkurrenca e mundshme ne tregun e aksesit ne LLU**

Pjesa e larte e tregut te nje operatori mund te mos jete tregues i fuqise se ndjeshme ne treg, ne rast se nuk plotesohen nje sere kushtesh te tjera. Nje nder keto kushte eshte edhe egzistenca e barrierave ne treg.

Nese nje operator ka pjese te madhe ne treg, por nderkohe tregu eshte i hapur ndaj operatoreve te rinj, te cilet mund te hyjne dhe dalin nga tregu pa kufizime ligjore dhe kosto ekonomike, atehere aftesia e nje operatori me pjese te madhe tregu per te ndikuar ne kete treg eshte e kufizuar. Por operatoret incumbent sipas te gjitha praktikave nderkombetare duke qene se kane si trashegimi infrastruktura dhe rrjete te ngritura ne kohe, konsiderohen si operatore ne avantazh te ndjeshem me te gjitha hyrjet e reja per te gjitha sherbimet qe suportohen ne keto rrjete. Per rrjedhoje edhe aksesit ne rrjetin lokal te hapur (LLU), gezon kete avantazh per operatorin incumbent Albtelecom.

Veshtiresia e hyrjeve te reja per te dublikuar infrastruktura paralele te rrjeteve, rrjete te cilat konkurojne rrjetin e Albtelekom, ne nje kohe te konsideruar (afat shkurter apo afatmesme), perben nje pengese serioze edhe pse jo me natyre ligjore ne zhvillimin e konkuresces efektive. Pengesat me natyre ekonomike jane jo me pak te rendesishme dhe duhen trajtuar si barriere e konsiderueshme per hyrjet e reja.

Ne te gjitha praktikat me te mira te BE-se (dhe jashte vendeve te BE-se), potenciali i operatoreve incumbent ne zhvillimin e tregut te aksesit ne broadband bazuar ne aksesin ne rrjetin lokal te hapur LLU, eshte konsideruar i pazevendesueshem dhe si nje treg qe duhet analizuar per FNT kryesisht per operatoret incumbent, ndaj ne situaten reale te ketij tregu ne Shqiperi nuk egzistojne faktore te ndryshem me ato te vendeve te tjera per te bere raste perjashtimore per operatorin incumbent Albtelecom.

#### **Pengesa ligjore**

Ndryshimi kryesor ne lidhje me pengesat per hyrjen ne treg, eshte liberalizmi i tregut dhe lehtesimi i procedurave per sipermarresit ne sektorin e komunikimeve elektronike, qe solli hyrja ne fuqi me 26.06.2008 e Ligjit Nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” dhe kuadrit rregullator te tij, vecanerisht sistemi i Autorizimeve te Pergjithshme. Hyrja ne fuqi e ketij Ligji ka hequr pengesat ligjore per ofrimin e sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike ne shkalle kombetare qe ekzistonin ne Ligjin e meparshem Nr. 8618.

Zevendesimi i sistemit te komplikuar te licensimit me licensa te klasave te ndryshme dhe per zona operimi te percaktuara me sistemin e autorizimit te pergjithshem perben nje eliminim apo reduktim te ndjeshem te pengesave ligjore ne ofrimin e sherbimit aksesit ne rrjetin lokal te hapur.

Megjithë keto ndryshime ligjore, ne ofrimin e aksesit ne rrjetin lokal te hapur LLU, egzistojne pengesa strukturore te konsiderueshme per te bere te mundur kete akses. AKEP gjykon se konkurrenca e mundshme nga operatorët aktuale dhe te rinj per nje periudhe afatmesme nuk do te jete e mjaftueshme per te kufizuar apo eliminuar aftesine ndikuese ne treg te Albtelecom, per arsye se Albtelecom zoteron disa avantazhe ndaj operatoreve aktuale dhe te mundshem te cilat do te vazhdoje t'i kete edhe ne nje periudhe afatmesme. Nder keto avantazhe te Albtelecom, apo pengesa strukturore te aksesit ne LLU, mund te permendim avantazhet qe vijne si operator rrjeti kombetar te telefonise fikse (rrjet lokal dhe backbone):

### **Ekonomite e shkalles**

Ekonomite e shkalles perfitohen kur kostoja per njesi e sherbimit zvogelohet me rritjen e sasise se sherbimit. Ne ofrimin e sherbimeve te telekomunikacioneve, ekonomite e shkalles jane te konsiderueshme, dhe kjo perben nje pengese per operatore te rinj per te konkurruar me nje operator me rrjet te shtrire ne te gjithe territorin e nje vendi. Operatori Albtelecom si operator i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me te gjithe sipermarresit e tjere ne tregun e komunikimeve elektronike qe mundesojne ofrimin e sherbimeve te tyre te bazuara ne kete rrjet dhe ne teknologjite qe mbeshteten mbi kete rrjet.

Albtelecom duke patur nje rrjet infrastrukturor backbone edhe ne tregun e aksesit ne rrjetin lokal te hapur (LLU), trashëgon nje status te tille. Dimensionin e shtrirjes se rrjetit perben nje pozicion dominant ne raport me sipermarres te tjere ne kete treg.

*Si konkluzion themi qe:*

*Albtelecom ka prezence me nje infrastrukture me kapacitet ne shtrirje gjeografike ne ofrimin e aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur (LLU), dhe si rrjedhoje kjo perben nje avantazh te padiskutueshem te Albtelecom.*

### **Ekonomite e densitetit**

Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh ne ofrimin e aksesit ne rrjetin e hapur lokal (LLU). Albtelecom ka qene i vetmi operator rrjeti i lejuar te ndertoje rrjet ne zonat urbane te cilat jane zona me dendesi shume me te madhe se zonat rurale. Me liberalizimin e tregut ne zonat urbane kete avantazh e kane edhe operatorët qe investojne ne keto zona ne krahasim me operatorët ne zonat rurale.



## **Integrimi vertikal**

Prezenca e nje operatori ne dy nivele te tregjeve, me shumice dhe me pakice, d.m.th. integrimi vertikal rrit aftesine ndikuese ne treg te operatorit. Operoret e rrjeteve telefonike publike jane vertikalisht te integruar. Nje integrim i tille eshte argumentuar ne te gjitha analizat e tregut qe nga 2007, 2009 te cilat kane gjetur Albtelecom me FN ne tregjet e analizuara. Avantazhet e krijuara nga madhesia e rrjetit (niveli me shumice), prezenca me linja abonentesh ne te gjitha rrethet e RSH (niveli me pakice) te operatorit Albtelecom jane shume me te medha se ato te operatoreve te tjere (rurale) dhe operatoreve te rinj te mundshem ne treg. Nje operator vertikalisht i integruar, ka mundesine qe te krijojte avantazhe (diskriminoje) per pjesen e tij te ofrimit te sherbimeve ne nivelin me pakice ndaj konkurrenteve te tjere per keto tregje perkatese me pakice, duke perdorur aftesine ndikuese ne nivelin (tregjet) me shumice, pra duke ofruar sherbimet (inpute per tregjet me pakice) ne nivelin me shumice konkurrenteve te tij me cmime me te larta se ai ofron per pjesen e vet te tregut me pakice.

*Per rrjedhoje megjithë eliminimin apo reduktimin e ndjeshem te pengesave ligjore, qe erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator te Autorizimeve te Pergjithshme, Albtelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere per shkak te ekonomive te shkalles, ekonomive te densitetit, integrimin vertikal. Keto avantazhe te Albtelecom, ne rrjetin lokal dhe backbone, ndikojne pozitivisht ne aftesine ndikuese te Albtelecom ne tregun e shumices te aksesit ne rrjetin lokal te hapur (LLU).*

## **IV. Fuqia kundervepruese e bleresve**

Pozita e nje operatori, qe eshte dominant ne ofrimin e nje sherbimi, mund te jete me e dobet nese egzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit te shitesit per te mos humbur kete klient. Por fuqia kundervepruese e bleresve qe kerkojne te hyjne ne tregun e aksesit ne broadband bazuar ne rrjetin lokal te hapur, eshte nje faktor i dobet per te ushtruar presion pozitiv qe do te ndikonte tek Albtelecom qe ofron kete sherbim per arsyen kryesore qe mbi te gjitha ky sherbim do te ofrohej tek abonentet e rrjetit te Albtelecom, gje e cila do te dobesonte padiskutim peshen e cdo sipermarresi ne raport me vete Albtelecom.

Fuqia kundervepruese ekziston ne tregun e shumices ne rast se operatori qe zoteron nje pozite te forte ekonomike, reflekton ne treg rritje te cmimit te aksesit dhe sherbimeve ne tregun e shumices dhe ne se fuqia negociuese e operatoreve te aksesuar ne kete treg nuk mjafton per te ndryshuar cmimin e ngritur, percakton nje pozicion me fuqi kundervepruese te dobet ne kete treg.

Ndaj per vete dimensionin qe ka Albtelekom, per shtrirjen gjeografike, si dhe per vete natyren e ketij tregu ne rrjetin lokal te hapur, pesha e Albtelecom do te ishte e padiskutueshme, per te gjitha avantazhet e detajuara me siper.

## **V. Pervoja rregullatore dhe rekomandimet e ERG bazuar ne praktikat me te mira**

Identifikim i LLU (Local loop unbundling) si dhe analizat e kryera ne kete treg nga rregullatore ne ndryshem kombetar ka mundesuar ne nje qendrim te perbashket te ERG per kete qellim.

Ne rrethana te ndryshme kombetare per rregullatore te ndryshem rezultojne nder te tjera elemente te perbashket ne analizen e ketij tregu, ne gjetjen e FNT si dhe masat rregullatore te propozuara per tu vendosur ne kete treg. Ndryshimi konsiston kryesisht ne implementimin e ketyre masave ne varesi te rrethanave kombetare, por ne mungese te gatishmerise vullnetare te operatoreve incumbent per te ofruara akses ne rrjetin lokal, si dhe domosdoshmeria e ketij aksesit per te dhene nje shtyese te fuqishme ne zhvillimin e tregut te broadband, ka vendosur rregullatoret ne pozicione dominuese ne percaktimin e detyrimeve konkrete qe kane te bejne me detyrimet standarte te aksesit, transparences dhe mosdiskriminimit, detyrime te cilat jane te aplikuar dhe te vendosura edhe ne analizat e zhvillura me pare qe kane ne focus rrjetin fiks te operatoreve incumbent. Por masa e vecante me karakter detyrues eshte kontrolli i cmimeve dhe ndarja e llogarive, me qellim percaktimin e tarifave qe orientohen drejt kostove qe mundesojne ofrimin e aksesit ne LLU, duke mos lejuar te kalojne ne nje barre te tepert per perfitusit e ketij aksesit.

Praktikat rregullatore te mbajtura ne vendet e BE-se, mundesojne nder te tjera edhe specififikimet dhe vendosjen e detyrimit per RUO (oferte reference per unbundling) si dhe lejon perdorimin e benchmark-ut ne lidhje me percaktimin e tarifave qe duhen ofruar nga operatori incumbent per aksesin ne rrjetin lokal ne dy versionet e tij (full dhe shared)

Praktikat me te mira sipas pervojave rregullatore te BE-se si dhe qendrimit te perbashket te ERG kane identifikuar tre elemente te rendesishem dhe konkretisht me natyre:

- c) Operacionale, ne te cilen eshte perfshire Cilesia e Sherbimit;
- d) Funksionale, ne te cilen percaktohen elementet e hartimit te RUO-s;
- e) Ekonomike, ne cilen percaktohen tarifat per aksesin (full dhe shared);


### **Tarifimi per Unbundled Local Loop sipas praktikave rregullatore te BE-se**

Aksesi ne rrjetet lokale te hapura (LLU), si nje mundesi per rritjen e shpejte te aksesit ne broadband, ne vende te ndryshme jane percaktuar tarifat nga rregullatore kombetare, kjo edhe per faktin qe vete operoret incumbent ne menyre vullnetare nuk ofrojne akses ne rrjetin lokal te hapur.

Arsyet per kete jane trajtuar me siper, por ne nje permbledhje te shkurter mund te themi qe arsyeja kryesore eshte se aksesit ne rrjetin lokal te hapur u mundeson sipermarresve te tjere t'u ofrojne akses pajtimtareve te rrjetit te operatorit incumbent. Per rrjedhoje eshte e nevojshme nderhyrja rregullatore dhe kjo nderhyrje duhet te konsistoje deri ne kontrollin e cmimeve dhe ndarjen e llogarive per operatorin incumbent.


Nisur nga praktikat ne vende te ndryshme europiane, me poshte do te ilustrujme me fig. perkatese ne te cilat jane paraqitur cmimet per LLU (akses full dhe shared). Konkretisht:

Ne kete grafik (fig.1 dhe fig.2) eshte paraqitur kostoja mesatare per LLU (shared dhe full) per vende te ndryshme, si dhe kostoja mesatare per EU, e cila eshte perlloritur si kosto mesatare mujore bazuar ne nje vlersim mbi tre vjecar ne euro.



Spain: The cost of the test and disconnection fees is included in connection  
Netherlands: 2008 data as of 1-7-2008

**Fig.1 Burimi: EC 14 th implementation report**




Figures 2005 entries do not include data for Bulgaria and Romania.

**Fig.2 Burimi: EC 14 th implementation report**


Ilustrimi per sa siper paraqitet edhe ne grafiket e (fig.3 dhe fig.4), ne te cilet eshte perlloritur kostoja mesatare mujore ne dy sherbimet e full akses dhe shared akses, duke u zgjedhur vlera e perlloritur ne tetor 2008.

Konkretisht:



Spain: The cost of the test and disconnection fees is included in connection  
Finland: weighted average of 31 SMP operators providing ULL.


**Fig.3 Burimi: EC 14 th implementation report**



Spain: The cost of the test and disconnection fees is included in connection


**Fig.4 Burimi: EC 14 th implementation report**

Referuar kostove te perlogaritura sipas ilustrimit te mesiperm, me poshte do te paraqiten cmimet e pellogaritura per LLU ne dy versionet (full dhe shared) , per tarifen e instalimit e cila paguhet vetem njehere si dhe tarifen mujore ,dhe konkretisht paraqiten te ndara ne (fig.5, fig.6 per versionin full) si dhe (fig.7, fig.8 ne versionin shared) si me poshte:




Spain: The cost of the test and disconnection fees is included in connection  
Finland: weighted average of 31 SMP operators providing ULL.

**Fig.5 Burimi: EC 14 th implementation report**



Finland: weighted average of 31 SMP operators providing ULL.

**Fig.6 Burimi: EC 14 th implementation report**



*Spain:* The cost of the test and disconnection fees is included in connection

Fig.7 Burimi: EC 14 th implementation report




Fig.7 Burimi: EC 14 th implementation report

## V.Perfundim per FNT

Bazuar ne kriteret e perdorura ne vleresimin dhe analizen per FN te Albtelcom ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU), rezulton se faktoret themelore te analizuar dhe qe percaktojne FNT per Albtelcom jane:

- Pjesa e tregut per Albtelcom rezulton te jete 100% e tregut te mundshem hipotetik, bazuar ne arsyetimin e dhene me siper;
- Pamundesia e sipermarresve te tjere ne dublikimin e infrastruktures se rrjetit te Albtelcom , ne peridudhe afatmesme;
- Avantazhet e ekonomive te densitetit; te ekonomise se shkalles; integritit vertikal ;
- Mungesa e fuqise kundervepruese te bleresve;
- Praktikat me te mira rregullatore ne vendet e tjera, justifikojne FNT te operatorit incumbent;

**Bazuar ne sa siper, arrihet ne konkluzionin se:**

*Albtelecom eshte operator me Fuqi te Ndjeshme ne tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit te tij nga nje vendodhje fikse perfshire aksesin e plote dhe te ndare.*

## **VII. MASAT RREGULLUESE PER FNT NE TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT FIZIK NE RRJETET E HAPURA LOKALE**

Ne baze te analizes se kryer rezulton se Albtelecom permbush kushte per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e aksesit fizik ne rrjetin e hapur lokal (LLU) dhe konkretisht:

- **Tregu me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.**

### **VII.1 Problemet e konkureses sipas praktikave me te mira rregullatore**

Prezenca e operatoreve incumbent ne dy nivelet e tregjeve si pasoje e integritit vertikal te tyre, dominanca ne teresine sherbimeve qe bazohen ne rrjetin e tij, ben te mundur qe problemet qe shfaqen te jene te nje natyre qe kane lidhje me:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- tarifa shume te larta;
- diskriminim ne tarifa dhe cilesi;
- investim i tepert apo i manget;
- dhenia e sherbimeve me shporta (bashkimi i sherbimeve) etj

Probleme te tjera te cilat ne kushtet e nje dominance te tille jane prezente sipas te gjitha praktikave rregullatore jane:

- Mungesa e marrveshjeve te nivelit te sherbimit per afatet dhe cilesine e ofrimit aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur LLU (dy versionet full dhe shared)
- Diskriminimi i operatoreve te telekomunikacioneve (ofruesve te sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike) ne termat e sherbimit (cilesi dhe cmim);
- Mosdhenie e informacionit te mjaftueshem ne lidhje me prezencen gjeografike te rrjetit lokal, te pikave te aksesit si dhe te kapaciteteve teknike te mundshme;
- Identifikimi i kerkesave te arsyeshme per zgjidhje dhe percaktimi i kohes se nevojshme qe mundesojne zgjidhjen e ketyre kerkesave;
- Mungesa e nje dokumenti reference qe parashikon te gjitha rastet e zgjidhjes se kerkesave te arsyeshme dhe qe mundeson arritjen e marreveshjeve te bashkepunimit ndermjet operatorit incumbnt dhe sipermarresve te interesuar per akses fizik ne LLU;



Rekomandimet e ERG per zgjidhjen e ketyre problemeve jane vendosja e detyrimeve per dhenie akses, mosdiskriminim, transparence dhe orientim ne kosto te tarifave te aksesit fizik per full dhe shared ne rrjetin lokal te hapur, masa te cilat do te rrisnin mundesine konkurruese te operatoreve/ofruesve te rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike ne tregjet me pakice te linjave me qera dhe sherbimet e tjera te komunikimeve elektronike si dhe perfitimet e perdorueve. Nje mase e rendesishme rregulluese per FNT per aksesin fizik ne rrjetin lokal te hapur (LLU), eshte shoqerimi i detyrimit te mos-diskriminimit me detyrimin per dhenien e Garancive apo Marrveshjes se Nivelit te Sherbimit (*service level agreement-SLA*) si dhe publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (*Key Performance Indicators -KPI*). Nepermjet ketyre detyrimeve, sipermarresi me FNT detyrohet te paguaje kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimit te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort ne marreveshjen e bashkepunimit.

## VII.2 Masat Rregulluese per FNT te Albtelecom per LLU

Ne baze te parashikimeve te ligjit, neni 34, *Nese AKEP-i percakton se nje ose disa sipermarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

Bazuar ne pershkrimin e problematikes se cituar me siper, si dhe referuar pervojave me te mira rregullatore, edhe pse aktualisht ne mungese te ketij tregu, por duke qene te bindur se ne mungese te nderhyrjes nga AKEP, mundesia qe ky treg te zhvillohet ne menyre vullnetare nga Albtelecom nuk egziston, atehere AKEP gjykon se masat e nevojshme qe duhen propozuar ne kete draft analize per t'u vendosur ndaj Albtelecom, me reference ne parashikimet e Ligjit 9918, jane:

6. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
7. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
8. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
9. Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
10. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Detyrimet e mesiperme midis te tjerave perfshijne:

- Publikimin e ofertes reference te aksesit ne rrjetin hapur lokal te Albtelecom per aksesin fizik ne LLU. Albtelecom do te duhet te zbatoje procedurat dhe rregullat

per publikimin dhe permbajtjen e oferte reference jane parashikuar ne Ligj dhe ne rregulloren e Akses dhe Interkoneksionit. Oferta reference duhet te permbaje te gjithë termat dhe kushtet e aksesit ne rrjet, perfshire ato te sherbimeve ndihmese, termat dhe kushtet kryesore kontraktuale.

- Albtelecom duhet te mos diskriminoje midis operatoreve te ndryshem dhe midis operatoreve te tjere dhe klienteve, filialeve te veta dhe per kete do te duhet te kete;
  - *Detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur;*
  - *Detyrimi per te ofruar marrveshje te Nivelit te Sherbimit (service level agreement-SLA)*
  - *Detyrimi per te paguar kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimit te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort.*
  - *Detyrim per informacion dhe shpjegime te plota, bazuar ne rregullat dhe procedurat e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);*
  - *Detyrimin per percaktimin e kerkesave te arsyeshme dhe publikimin e tyre, si dhe dhenien e arsyeve te refuzimit (ne rast se ka) dhe publikimi e ketyre arsyeve;*
  - *Detyrimin per percaktimin e afatit kohor ne shqyrtimin e kerkeses se arsyeshme dhe realizimin e saj;*

### **Kontrolli i tarifave te aksesit fizik ne LLU dhe orientimi ne kosto**

Si nje problem qe duhet peshuar drejt, me qellim vleresimin e kostove te ofrimit te ketij sherbimi nga ana e Albtelecom si dhe ne perputhje me praktikat me te mira rregullatore, tarifimi per aksesin fizik ne rrjetin lokal te hapur (LLU) duke perfshire dy versionet e ketij aksesit (full dhe shared) si dhe referuar Ligjit Nr. 9918, ne Nenin 7 (pika 3) te tij, ne te cilin percaktohet midis te tjerave se:

*AKEP-i nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të*

*komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:*

*a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me nevoja të veçanta, që kundrejt tarifave në çdo rast jo më të larta se tarifat mesatare të vendeve të BE-së, mbi bazën e përzgjedhjes të përfitojnë maksimalisht shërbime alternative, cilësore dhe në përputhje me standardet e miratuara nga AKEP-i;*

Duke konsideruar si te nevojshme ne kushtet reale ku egziston zhvillimi ketij tregu, me qellim nxitjen e zhvillimit te ketij tregu, AKEP gjykon se eshte e nevojshme te percaktoje tarifen e instalimit; tarifen mujore te aksesit fizik ne LLU per (aksesin e plote dhe te ndare). Keto tarifa

nuk duhet te jene me te medha se niveli mesatar i vendeve te BE-se. Per metoden e rregullimit te tarifave, AKEP gjykon qe fillimisht, per nje periudhe 1 vjecare te aplikojte metoden e cmimit tavan apo maksimal, duke perdorur si reference nivelin mesatar te vendeve te BE, apo praktiken me te mire te vendeve te BE. Keto metoda jane te parashikuara ne nenin 57, pika 1/a dhe 2/a dhe 2/b.

Per periudhe afatgjate, AKEP gjykon se tarifat e orientuara ne koston eficiente te ofrimit te aksesit fizik ne LLU, eshte metoda me e mire e tarifimit, dhe metoda LRAIC e rekomanduar nga KE, eshte metoda me e mire per nxitjen e konkurrences efektive ne kete treg.

***AKEP ka kontraktuar nje kompani konsulente nderkombetare per percaktimin e kostove te sherbimeve te Albtelecom, me modelin BULRAIC(Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost), dhe nder outputet e modelit do te jene edhe kostoja e ofrimit per LLU dhe rekomandime per tarifimin e tyre.***

Detyrimi i orientimit ne kosto te tarifave te aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur eshte ne perputhje nenin 45 te Ligjit, si edhe nenin 59/2 per perdorimin nga AKEP te metodave te llogaritjes se koston efciente te pavaruara nga operatori.

AKEP pas marrjes se rezultateve dhe rekomandimeve te ketij projekti, gjykon se do jete nevojshme te zhvilloje nje konsultim publik per marrjen nje vendimi per rregullimin e tarifave te gjitha sherbimeve qe jane perfshire ne kete projekt, nder te tjera edhe ofrimi i LLU-se.

### **Parime ne percaktimin e tarifave per LLU**

- Tarifat duhet te jene te ngjashme me tarifat per sherbimet e interkoneksionit ne tregun e shumices;
- Kostot qe krijon aksesin ne LLU-se duhet te jene te uleta, me qellim inkurajimin e operatoreve te rinj qe marrin keto sherbime;
- Kostot e krijuara si rezultat i implementimit te LLU-se duhen mbuluar nga operatori incumbent;

### **Struktura e kostove per LLU per operatorin incumbent**

Kostot duhet te jene te strukturuara dhe te lejojne operatorin incumbent te mbuloje veprimet operative si:

- Administrimi;
- Zhvillimi i produkteve te reja;
- Zhvillimi i proceseve mbeshtetese;
- Zhvillimin e mbeshtetjes operationale;

Ne tabelen me poshte jepen tarifat e propozuara nga AKEP per ofrimin e aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur LLU dhe konkretisht:

**Tab.1 Propozimi per tarifat qe duhen vendosur nga Albtelekom per LLU**

Pershkrimi per LLU-ne	ALBTELEKOM		BE - 27 (tetor 2008)	
	tarifa mujore ne leke (pa tvsh)	tarifa e instalimit ne leke (pa tvsh)	tarifa mujore (ne euro)	tarifa e instalimit (ne euro)
Akses shared LLU	400	6500	2.62	54.17
Akses full LLU	1200	7000	9.28	57.54

Ne tabele jane dhene tarifat mujore sipas aksesit (full dhe shared) si dhe tarifa e instalimit e cila paguhet vetem njehere ne momentin e instalimit.

## **ANEKS 2. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIMI ME PUBLIKUN PER TREGUN E SHUMICES TE AKSESIT FIZIK NE RRJETIN LOKAL (LLU)**

**Me poshte eshte nje permbledhje e pyetjeve per te cilat AKEP eshte i interesuar te marre komente nga palet e interesuara. Palet mund te japin komente edhe per pjese te tjera te dokumentit te analizes dhe perfundimeve te arritura nga AKEP.**

*LLU (hapja e rrjetit lokal te operatorit inkumbent fiks) nuk eshte ende prezent ne Shqiperi.*

1. A jeni dakort me konkluzionin e aritur ne analize qe tregu i shumices te aksesit fizik ne rrjetin lokal duhet te behet aktiv?
2. A jeni dakort me konkluzionin e aritur ne analize se Albtelecom ka Fuqi te Ndjeshme ne kete treg dhe se eshte propozuar si OFNT ne kete treg?
3. A jeni dakort me masat rregullatore te propozuara nga AKEP per kete treg?
4. A jeni dakort me percaktimin e tarifave mbi bazen e benchmark-ut te BE-se per tetor 2008, ne lidhje me :
  - a) Tarifen e instalimit;
  - b) Tarifen e pajtimit mujore te aksesit te ndare;
  - c) Tarifen e pajtimit mujor te aksesit te plote;
5. Cfare masash te tjera rregullatore mendoni se jane te nevojshme per LLU-ne?

